



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMPANISË RAJONALE TË UJËSJELLËSIT "PRISHTINA" SH. A. PËR VITIN 2023

Raporti i nënshkruar nga  
Vlora Spanca,  
Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, qershor 2024

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Komentet e NP-së në gjetjet e raportit të auditimit

Shtojca II: Pasqyrat financiare vjetore të audituara

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Kompanisë Rajonale të Ujësjetës "Prishtina" Sh. A. për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Kompanisë Rajonale të Ujësjetës "Prishtina" Sh. A. (KRUP), të cilat përmbajnë pasqyrën e pozitës financiare për vitin 2023, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e rrjedhës së parasë së gatshme, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme kontabël, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjes/ve së përshkruar në paragrafin Baza për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare të bashkangjitura për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale të pozitës financiare të Kompanisë Rajonale të Ujësjetës "Prishtina" Sh. A. deri me 31 dhjetor 2023, performancës së saj, si dhe rrjedhës së parasë së gatshme për vitin 2023, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

## Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1 Në regjistrin e pasurive janë identifikuar dobësi si: 92 pasuri të cilat kishin vlerën neto në libra kontabël zero dhe kosto e tyre historike zero. Po ashtu, kompania kishte 3,510 pasuri të cilat kishin vlerë kontabël zero, por të cilat ishin ende në përdorim dhe kishin kosto historike 12,730,325€. Fakti që këto pasuri janë në përdorim në rast të një rivlerësimi vlera e tyre financiare mund të jetë materialisht e ndryshme nga vlera e tyre e prezantuar. Për shkak të natyrës së çështjes auditori nuk ka arritur të vlerësojë vlerën financiare të pasurive të cilat janë në përdorim nga entiteti dhe kanë vlerën kontabël zero.
- A2 Kemi identifikuar që kompania nuk kishte trajtuar projektet kapitale në mënyrën e duhur për shkak se ato pasuri i kishte regjistruar në pjesë veçanta dhe jo si projekte të plota. Pra, regjistrimin e pjesëve (pozicioneve) e kishte bërë nëpër kategori të ndryshme dhe me norma të ndryshme të zhvlerësimit. Ne e kishim të pa mundur të identifikojmë nëse të gjitha pozicionet e projekteve ishin regjistruar dhe kapitalizuar. Për shkak të natyrës së çështjes dhe mungesës së dokumenteve burimore auditori nuk ka arritur të vlerësojë vlerën financiare të pasurive të cilat janë në përdorim nga entiteti. Po ashtu auditori nuk ka arritur të vlerësojë efektin e ndarjes së pasurive dhe vlerësimin e gabimit financiar për shkak se kompania kishte aplikuar dy metoda të trajtimit prandaj gabimi konsiderohet material në aspektin e keqdeklarimit.

- A3 Raporti i komisionit të inventarizimit kishte konstatuar se mungojnë 132 pasuri, të cilat vlerën neto në libra e kishin 12,267€. Kostoja historike e tyre ishte 208,224€ por në regjistrin e pasurisë të vitit 2023 nuk figurojnë fare. Arsyeja e mos përfshirjes në regjistrin e vitit 2023 ishte se zyrtarët e kompanisë kishin hequr ato nga regjistri i pasurive. Këtë veprim e kishin bërë duke u bazuar në vendimin e Bordit të Drejtorëve i cili kishte aprovuar raportin e komisionit të inventarizimit.
- A4 Kemi identifikuar se në katër (4) raste kishte diferenca në mes të saldove të kompanisë dhe klientëve përkatës në vlerë totale prej 3,028€. Po ashtu, përmes procedurave tjera audituese, në dy (2) raste janë identifikuar mospërputhje në bilancin e llogarive të arkëtueshme për ish ndërmarrjet shoqërore, tashmë të privatizuara për shkak se saldo e LLA është paraqitur në shumën 39,152€ ndërsa duke ju referuar dokumenteve burimore, përkatësisht dokumenteve të Autoritetit të Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore kjo saldo është 0€ pasi kërkesa ishte refuzuar në tërësi. Ne kemi vërejtur se Kompania për 16 letër konfirmimet të tjera në vlerë prej 74,513€ nuk i kishte dërguar te klientët për shkak të mungesës së të dhënave kontaktuese. Fakti i mungesës së të dhënave për klientë pa mundëson konfirmimin e llogarive të arketueshme.
- A5 Kompania kishte përpiluar shënimet shpjeguese si pjesë përbërëse e pasqyrave financiare, megjithatë informacioni i dhënë nga kompania në shënimet shpjeguese është i mangët në lidhje me: klasifikimin e stoqeve për vlerën totale 1,506,405€, burimin e financimit të granteve në vlerë 27,668,782€, lidhur me shlyerjet e pasurive të patundshme në vlerë 1,176,234€, shpenzimet e interesit dhe transferet 136,026€ si dhe parapagimin e tatimit në pronë në vlerë 93,015€.
- A6 Kompania në pasqyrën e pozicionit financiar kishte prezantuar parapagimet dhe të arkëtueshmet tjera në vlerë 323,351€ mirëpo ne kemi identifikuar se vlera e tyre nuk ishte e saktë për 28,450€.
- B1 Në gjashtë (6) letër konfirmime të pranuar kishte diferenca në mes të saldove të kompanisë dhe furnitorëve përkatës. Kompania kishte prezantuar më shumë obligime se sa kanë konfirmuar furnitorët. Fakti që kompania nuk kishte bërë barazimet periodike me klientët ka rezultuar që për llogaritë e pagueshme të ketë diferenca në 67,773€. Po ashtu, fatura në vlerë totale prej 13,309€ që ka të bëjnë me shpenzimet e ndodhura të vitit 2023 është regjistruar në vitin 2024. Kjo ngjarje ka bërë që llogaritë e pagueshme të vitit 2023 janë nënvlerësuar për shumën 13,309€.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'.

Në përputhje me ONISA-P-10 dhe SNISA 130, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të Ndërmarrjeve Publike, Kodin e Etikës të ZKA-së, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.



## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion, transaksionet e kryera të Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Prishtina" Sh. A. kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

## Baza për konkluzion

- A7 Gjatë auditimit të procesit të rekrutimit për tri pozita të shpallura në konkurse të ndryshme (kontabilist, zyrtar i lartë në shërbimin e faturimit dhe inspektor në shërbimin për kontroll dhe shkyçje) kemi vërejtur se kompania kishte pranuar dokumente pas datës së mbylljes së konkurseve. Dokumentet e pranuar ishin si përvoja e punës, certifikata e lindjes, certifikata që nuk është nën hetime.  
Për pozitën "kontabilist" kandidati nuk kishte ofruar dëshminë e përvojës së punës (trustin) siç kërkohej në shpallje të konkursit. Meqenëse kompania kishte mundësuar që kandidatët të ofrojnë dokumente shtesë, në rastin konkret kandidati kishte ofruar dëshminë e përvojës së punës jo të plotë dhe përkundër kësaj kompania kishte nxjerrë aktvendim për themelimin e marrëdhënies së punës.
- A8 Për projektin "Rehabilitimi dhe Ndërtimi i Ujësjellësit e Kanalizimit në Komunën e Shtimës", me vlerë të kontratës 220,101€, Autoriteti Kontaktues kishte shpërblyer me kontratë operatorin ekonomik jo të përgjegjshëm, pasi që nuk kishte përmbushur kërkesat sipas dosjes së tenderit për kapacitetin teknik dhe profesional.
- B2 Kompania nuk kishte lidhur kontrata me të gjithë konsumatorët që marrin shërbimet e ujit. Sipas regjistrit të konsumatorëve kompania ofron shërbime për 187,010 konsumatorë ndërsa kishte lidhur kontrata vetëm me 110,287 apo 59% të numrit total. Krahasuar me vitin paraprak kemi një rritje të numrit të kontratave të lidhura me konsumatorë (70,242 kontrata apo 42% e numrit total të konsumatorëve).
- B3 Në regjistrin e konsumatorëve ekzistojnë 55 konsumatorë të cilët janë evidentuar me përshkrimin "NN" (pa emër dhe mbiemër) dhe shkurtesa të tjera dhe shuma financiare që këta konsumatorë i detyrohen Kompanisë është 58,712€ si dhe 65,740 konsumatorë të cilëve u mungon numri personal.
- B4 Ne kemi vërejtur se kompania gjatë vitit 2023 kishte faturuar 477 konsumatorë të cilët nuk kishin të instaluar ujëmatës. Edhe pse kjo çështje ishte ngritur edhe në raportin e vitit të kaluar, kompania nuk kishte arritur të instaloj ujëmatësit.

- A9 Marrëveshja e nënshkruar në vitin 2023 për financim të projekteve në mes Ministrisë së Ekonomisë dhe KRU Prishtina në vlerë prej 440,000€ përcakton që 3 (tre) projekte të realizohen me mjetet e ME.  
KRU Prishtina nuk kishte respektuar kushtet e marrëveshjes për financimin e projekteve si, përmbushje të afateve kohore të kontratave, përzgjedhje të operatorit të përgjegjshëm, ndryshimi i kushteve një anshëm nga KRU e tjera. Prandaj si rrjedhojë e kësaj, KRU Prishtina kishte përfituar vetëm 67,658€, vetëm për një situacion të projektit për rehabilitimi dhe ndërtim të rrjetit të ujësjellësit në fshatin Kishnicë, ndërsa pjesën tjetër nuk i kishte përmbushur kushtet e marrëveshjes pasi që projekti ende nuk ka përfunduar.
- A10 Gjatë vëzhgimit të procesit të inventarizimit të stoqeve kemi identifikuar se artikujt nuk ishin të ndarë në kode të veçanta, pra në një kod ishin të përfshira më shumë se një artikull. Për më tepër, në disa raste ishin artikujt funksional dhe artikuj jashtë funksionit të përfshira në një kod.
- A11 Kompania edhe pse kishte nënshkruar kalimin e pronësisë për këto investime kapitale, ato i kishte regjistruar si investime në vijim por jo si pasuri në përdorim. Sipas kompanisë projektet e tilla nuk e kishin dokumentacionin e kompletuar dhe gjatë vitit 2023 ishin në proces të kompletimit të dokumentacionit. Megjithatë, ne kemi vërejtur se raporti i CDI (implementues i projektit) me nr. të protokolit 2761 i datës 08.11.2022 pasqyron projektet si të përfunduara.
- B5 Kompania në regjistrat kontabël ka të regjistruar një shumë financiare prej 663,740 € e cila ishte krijuar si rezultat i pagesave të klientëve/konsumatorëve të pa identifikuar ndër vite. Ne kemi vërejtur se kompania nuk ka të dhëna të sakta lidhur me klientët/konsumatorët e tillë dhe si rrjedhojë kjo vlerë ishte regjistruar në zërin kontabël me përshkrimin “Avanset nga pagesat e paidentifikuara të konsumatorëve”.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa ‘Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare’.  
Në përputhje me ONISA-P-10 dhe SNISA 130, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të Ndërmarrjeve Publike, Kodin e Etikës të ZKA-së, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

### **Informacione të tjera të ndryshme nga pasqyrat financiare dhe raporti i auditorit mbi to**

Menaxhmenti është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë informacionet në raportin e menaxhmentit dhe deklaratën e qeverisjes korporative, por këto informacione nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të auditorit mbi këto pasqyra.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se janë me anomali materiale.

Ne kemi marrë parasysh nëse informacionet në raportin për menaxhmentin janë në përputhje me informacionet në pasqyrat financiare dhe deklarata e qeverisjes korporative përfshinë shpalosjet e kërkuara me nenet 7 dhe 10 të ligjit 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

Nëse, bazuar në punën e kryer, arrijmë në përfundimin se në këto informacione ka një anomali materiale, atëherë ne duhet të raportojmë për këtë fakt.

### **Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë gjithashtu zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

Bordi i Drejtorëve është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Kompanisë Rajonale të Ujësjetës "Prishtina" Sh. A..

### **Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Kompanisë Rajonale të Ujësjetës "Prishtina" Sh. A. është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Kompanisë Rajonale të Ujësjetës "Prishtina" Sh. A. në përputhje me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, si dhe të gjitha ligjet, rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>2</sup>

## Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrim një raport të auditimit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është niveli i lartë sigurie, por nuk garanton se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keqdeklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, me arsye pritet që të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre Pasqyrave Financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të KRU "Prishtina", Sh. A. me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare. Si pjesë e auditimit, në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-t, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keqdeklarimit material të Pasqyrave Financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit; hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit konform atyre rreziqeve, si dhe sigurojmë dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të duhura për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i moszbulimit të një keqdeklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për keqdeklarimin që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulimin, falsifikimin, lëshime të qëllimshme, keqpërfaqësime apo anashkalimin e kontrollit të brendshëm.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo me qëllim të shprehjes së opinionit për efikasitet të kontrollit të brendshëm të Kompanisë Rajonale të Ujësjetës "Prishtina" Sh. A..
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura kontabël dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim një përfundim nëse baza e vijimësisë së kontabilitetit është e përshtatshme për përdorim nga menaxhmenti, bazuar në provat e siguruara të auditimit, nëse ekziston pasiguria materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të hedhin dyshime të rëndësishme në aftësinë e Kompanisë Rajonale të Ujësjetës "Prishtina" Sh. A., për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë. Nëse konkludojmë se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet përkatëse në Pasqyrat Financiare ose, nëse zbulimet e tilla janë të papërshtatshme ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona bazohen në provat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Sidoqoftë, ngjarjet apo kushtet e ardhshme mund të bëjnë që NP-ja të pushojë së vazhduari sipas parimit të vijimësisë.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e Pasqyrave Financiare, përfshirë edhe shpalosjet, për t'u siguruar se Pasqyrat Financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 19 rekomandime, prej tyre 14 është rekomandime të reja dhe 5 të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 3.

### 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

#### Çështja A1 - Dobësi në regjistrin e pasurive

##### Gjetja

SNK 16 pika 6, përcakton se, Kosto është shuma e mjeteve monetare ose ekuivalentëve të mjeteve monetare të paguara ose vlera e drejtë e shumës së dhënë për të blerë një aktiv në momentin e blerjes ose ndërtimit të tij. Po ashtu, SNK16 paragrafi 7 përcakton se kosto e një zëri të aktiveve afatgjata materiale do të njihet si aktiv nëse dhe vetëm nëse: a) është e mundshme që përfitimet ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij akitivi do të rrjedhin të njëjësia ekonomike; dhe b) kosto e aktivit mund të matet me besueshmëri.

Kompania në regjistrin e pasurive kishte të regjistruara pasuri afatgjata në vlerë prej 82,878,379€ të cilat i kishte prezantuar në pasqyra financiare. Dobësitë e identifikuar janë si në vijim:

- Në regjistër ekzistojnë 92 pasuri të cilat kishin vlerën neto në libra kontabël zero dhe kosto historike zero. Sipas përshkrimit të tyre, ato pasuri përfshijnë: pajisje të makinerisë, pajisje zyrës, automjete dhe dy ndërtesa.
- Janë identifikuar 16 ndërtesa të cilat janë të regjistruara me njësi matëse copë dhe jo me njësi matëse të sipërfaqes (m<sup>2</sup>);
- Po ashtu, kemi identifikuar se në regjistrin e pasurive janë 3,510 pasuri të cilat kishin vlerë kontabël zero, por të cilat ishin ende në përdorim dhe kishin kosto historike 12,730,325€ Kompania kishte shpalosur këto pasuri në pasqyra financiare vjetore.

Për shkak të natyrës së çështjes auditori nuk ka arritur të vlerësojë vlerën financiare të pasurive të cilat janë në përdorim nga entiteti dhe kanë vlerën kontabël zero.

Kjo kishte ndodhur për shkak se kompania nuk kishte arritur të rishikoj në tërësi regjistrin e pasurive ndër vite prandaj edhe në atë regjistër ekzistojnë çështjet e përshkruara më lartë.

**Ndikimi** Dobësitë e tilla në regjistrin e pasurive ndikojnë që regjistri i pasurive të mos jetë i plotë me informata financiare, të mos dihet saktë sipërfaqja e disa pasurive që mbahet në regjistra, dhe fakti që një numër i pasurive që është në përdorim dhe ka vlerën në libra zero në rast të një rivlerësimi vlera e tyre pasurive mund të jetë materialisht e ndryshme nga vlera e prezantuar zero. Këto mangësi ndikojnë në prezantim jo të drejtë dhe të vërtetë të pasurive në pasqyrave financiare.

**Rekomandimi A1** Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë, që të bëhet rishikimi i plotë i regjistrin të pasurive në mënyrë që të identifikoj të gjitha mangësitë si dhe të ndërmerr veprimet e nevojshme me qëllim që vlera e pasurive të prezantohet drejtë dhe saktë në pasqyra financiare vjetore.

### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)**

Me gjerësisht shih Shtojcën I

### **Çështja A2 - Mos trajtim i duhur pasurive afatgjata përkatësisht projekteve kapitale**

**Gjetja** SNK 16 Pasuritë Afatgjata përcakton se kosto e një zëri të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) përfshin:  
 (a) çmimin e tij të blerjes, përfshirë taksat doganore dhe taksat mbi blerjen jo të rimbursueshme, pasi zbriten skontot tregtare dhe zbritjet tregtare.  
 (b) çdo kosto të ngarkueshme drejtpërdrejtë për të sjellë pasurinë në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar nga drejtimi.  
 (c) vlerësimin fillestar të kostove të zbrërimit dhe heqjes së zërit dhe restaurimi i vendit në të cilin ai është vendosur. Një njësi ekonomike ekspozohet ndaj një detyrimi të tillë ose kur zëri sigurohet ose si pasojë e përdorimit të tij (zërit) gjatë një periudhe të caktuar për qëllime të ndryshme nga prodhimi i inventarëve gjatë asaj periudhe.

Gjatë auditimit kemi vërejtur se trajtimi i pasurive nuk bëhet sipas standardeve. Dobësitë e identifikuar janë si në vijim:

- Projekti " Zgjerimi dhe Zëvendësimi i Rrjetave të Amortizuara" nuk ishte i regjistruar si projekt kapital në vlerë 226,972€, por pozicionet e këtij projekti ishin ndarë dhe regjistruar në regjistrin e pasurisë. Në dy mostra të testuara vlera e tyre ishte e regjistruar në pozicione të ndara si "Gyp PE &Phi;560, PN 10" BAR me vlerë 161,915€ dhe "pjesët fazonike" në vlerë 10,225€. Për shkak të regjistrimeve të tilla ne e kishim të pamundur të vlerësojmë mënyrën e kapitalizimit të tyre.
- Projekti "Ndërtimi i Sistemit për Furnizim me ujë të pijshëm dhe industrial në Parkun në Drenas", nuk ishte regjistruar si projekt kapital në vlerë 984,583€, por pozicionet e këtij projekti ishin ndarë dhe regjistruar në regjistrin e pasurisë si pozicione të ndara si "Pompë zhytëse Horizontale Q=60 L/Sec H=37m P=32KW "në vlerë prej 12,300€.
- Projekti " Ndërtimi i Rrjetit të Ujit nga Rezervuari në Shkabaj për Gypin HDPE 100RC OD 630mm, në vlerë 277,127€ (pa Tvsh), ishte regjistruar në pozicione të ndara, ku për mostrën "Gyp HDPE RC OD - 630 mm, PN 10 bar" në vlerë 204,197€, ne e kishim të pamundur të



- vlerësojmë mënyrën e kapitalizimit të tyre.
- Te Kontrata " Furnizimi dhe Instalimi i Ujëmatësve Zonal në vlerë prej 91,268€" kemi vërejtur se kompania kishte regjistruar si pasuri nën pozicionet e ndara "valvola Shiber dn 150" të cilat kishin vlerën 185€ dhe nuk i kishte regjistruar si pasuri Ujëmatësin DN 150 mm në vlerë prej 10,666€.
  - Kontrata për "Rehabilitimit dhe Ndërtimi e Rrjetit të Kanalizimit në Shtime" në vlerë 17,909€, kishte regjistruar si "Gyp PESN8 315mm" në vlerë 13,822€, i cili gyp nuk kishte të kapitalizuar shpenzimet tjera që lidhen me projektin (punët përgatitore, demoluese etj).
  - Kontrata për " Zhvillim të softwerit në platformën Nav, Digjitalizimi dhe automatizimi" nuk ishte regjistruar si softer në vlerë 104,491€ (ashtu siç parasheh kushtet e veçanta të kontratës" por kompania e kishte regjistruar ndaras , "modulin e faturimit" në vlerë 39,662€.
  - Në regjistrin e pasurive kemi vërejtur se pasuria "Gyp kanalizimit sn8 1200mm, 4m" në vlerë 386,796€ ishte e regjistruar si pasuri ndaras por ndërlidhët me rrjetin e ujërave të ndotura. Ne e kishim të pamundur të identifikojmë ndarjen, kapitalizimin dhe trajtimin e tyre, për shkak se në emër të projektit "Rrjetin i ujërave të kanalizimit" në regjistrin e pasurive ishin përfshirë 1,097 pasuri për këtë projekt kapital.
  - Po ashtu pasuria "Gyp kanalizimit PESN8 Ø 315 në vlerë 448,019€ ishte e regjistruar si pasuri ndaras por ndërlidhët me projektin "Furnizim me ujë dhe kanalizim Prishtinë faza II". Ne e kishim të pamundur të identifikojmë ndarjen, kapitalizimin dhe trajtimin e tyre, për shkak se në emër të projektit në regjistrin e pasurive ishin përfshirë 23 pasuri.
  - Kompania kishte regjistruar si pasuri "Mirëmbajtjen e Licencave në vlerë 55,086€ për periudhën 2021-2023.

Për më tepër, ndarja ishte bërë nëpër kategori të ndryshme me norma të ndryshme të zhvlerësimit.

Po ashtu, kompania nuk kishte arritur të na ofroj dëshmi burimore për pesë (5) pasuri, të cilat kishin kosto historike 64,023€ dhe vlerë neto në libra 0.

Për shkak të natyrës së çëshjtes dhe mungesës së dokumenteve burimore auditori nuk ka arritur të vlerësojë vlerën financiare të pasurive të cilat janë në përdorim nga entiteti. Po ashtu auditori nuk ka arritur të vlerësojë efektin e ndarjes së pasurive dhe vlerësimin e gabimit financiar për shkak se kompania kishte aplikuar dy metoda të trajtimit prandaj gabimi konsiderohet material në aspektin e keqdeklarimit.

Kjo kishte ndodhur, për shkak se kompania nuk kishte një procedurë të shkruar lidhur me mënyrën e trajtimit të projekteve kapitale dhe kishte bërë ndarjen e projekteve duke i regjistruar ato në pjesë dhe duke kalkuluar norma të ndryshme të zhvlerësimit, të cilat nuk i kishte të përcaktuara me rregullore apo me procedurë të shkruar se cilat konsiderohen pjesë të rëndësishme.

#### **Ndikimi**

Trajtimi i tillë i pasurive dhe zhvlerësimi i tyre, përveç krijon pa qartësi lidhur me vlerën e projekteve investuese, ndikon edhe në shpenzimet e zhvlerësimit dhe rrjedhimisht reflekton që pasqyrat financiare të mos prezantojnë gjendjen e drejtë dhe të vërtetë të informatave financiare.



**Rekomandimi A2** Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë hartimin e një procedure të shkruar në mënyrë që trajtimi i pasurive respektivisht projekteve të cilat kanë të bëjnë me punë dhe furnizime të bëhet sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, në mënyrë që prezantimi i tyre të jetë sa më i drejtë.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)**

Me gjerësisht shih Shtojcën I

**Çështja A3 - Dobësitë e identifikuara nga raporti i inventarizimit të mjeteve themelore**

**Gjetja** Sipas nenit 7 të Ligjit nr.04/L014) për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, Shoqëritë tregtare verifikojnë të paktën një (1) herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dëshmime mbështetëse nëpërmjet procesit të inventarizimit. Inventarizimi i pasurive dhe detyrimeve kryhet nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara nga organi drejtues i shoqërive tregtare dhe duhet të barazohet me librat kontabël.

Raporti i komisionit të inventarizimit kishte konstatuar se mungojnë 132 pasuri, të cilat vlerën neto në libra e kishin 12,267€. Kostoja historike e tyre ishte 208,224€ por në regjistrin e pasurisë të vitit 2023 nuk figurojnë fare. Arsyeja e mos përfshirjes në regjistrin e vitit 2023 ishte se zyrtarët e kompanisë kishin hequr ato nga regjistri i pasurive. Këtë veprim e kishin bërë duke u bazuar në vendimin e Bordit të Drejtorëve i cili kishte aprovuar raportin e komisionit të inventarizimit.

Po ashtu, gjatë analizimit të raportit të inventarizimit vjetor, ne kemi vërejtur se raporti kishte identifikuar mangësi lidhur me regjistrimin e pasurive me një kod, si dhe pa qartësi në përshkrimin e artikujve të caktuar.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së procedurave të qarta lidhur me trajtimin e gjendjes së konstatuar të mungesës si dhe mungesës së kontrollit të brendshëm për të evidentuar mungesën e pasurive.

**Ndikimi** Mos harmonizimi i gjendjes faktike të pasurive me regjistrat kontabël ka rezultuar me prezantime dhe shpalosje jo të duhura të pasurive në pasqyra financiare.

**Rekomandimi A3** Bordi i Drejtorëve para aprovimit të raportit të inventarizimit duhet të sigurojë dëshmitë përkatëse (hulumtimin) lidhur me asetet që nuk ishin gjetur fizikisht nga komisioni por që ishin të regjistruara në regjistrin e kontabilitetit. Po ashtu, duhet të hartojë procedura të qarta për të siguruar që pasuritë e kompanisë të trajtohen në mënyrën e duhur.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)**

Me gjerësisht shih Shtojcën I

**Çështja A4 - Bilance të pa konfirmuara të llogarive të arkëtueshme****Gjetja**

Sipas Ligjit Nr. 06/L- 032 Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim Neni 12 Shoqëritë tregtare që i nënshtrohen dispozitave të këtij Ligji, verifikojnë të paktën një herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dëshmive të tyre mbështetëse nëpërmjet procesit të inventarizimit.

Për verifikimin e bilancit të llogarive të arkëtueshme (LLA), ne kemi kërkuar përmes Kompanisë të dërgohen te klientët 50 letër konfirmime.

Kompania kishte arritur të dërgoj vetëm 34 letër konfirmime tek klientët, mirëpo nga klientët janë kthyer vetëm nëntë (9) letër konfirmime. Prej tyre kemi identifikuar se në katër (4) raste kishte diferenca në mes të saldoeve të kompanisë dhe klientëve përkatës në vlerë totale prej 2,557€.

Po ashtu, përmes procedurave tjera audituese, në dy (2) raste janë identifikuar mospërputhje në bilancin e llogarive të arkëtueshme për ish ndërmarrjet shoqërore, tashmë të privatizuara për shkak se saldo e LLA është paraqitur në shumën 39,152€ ndërsa duke ju referuar dokumenteve burimore, përkatësisht dokumenteve të Autoritetit të Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore kjo saldo është 0€ pasi kërkesa ishte refuzuar në tërësi.

Ne kemi vërejtur se Kompania për 16 letër konfirmimet të tjera në vlerë prej 74,513€ nuk i kishte dërguar te klientët për shkak të mungesës së të dhënave kontaktuese. Fakti i mungesës së të dhënave për klientë pa mundëson konfirmimin e llogarive të arkëtueshme.

Kjo ka ndodhur për shkak se Kompania nuk ka aplikuar inventarizimin-harmonizimin me klientë dhe nuk ka të dhëna të kompletuara për klientët e saj.

**Ndikimi**

Mungesa e procesit të harmonizimit me klientë mund të rezultojë që të dhënat e pasqyrave financiare sa i përket llogarive të arkëtueshme të mos jenë të sakta.

**Rekomandimi A4**

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë procedura të harmonizimit periodik me partnerët ekonomik ashtu që pasqyrimi i llogarive të arkëtueshme të jetë i saktë.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)****Çështja A5 - Prezantim jo i plotë i shënimeve shpjeguese****Gjetja**

SNK 1 përcakton se, shënimet shpjeguese janë një element i pandarë i pasqyrave financiare. Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, prezantojnë informacionet shtesë në mënyrë që të plotësohen nevojat e përdoruesve me informacion mbi përbërjen e elementeve të bilancit dhe pasqyrës së të ardhurave. Ato zakonisht përmbajnë informacion edhe për politikën kontabël të përdorura nga njëësia ekonomike për hartimin e pasqyrave financiare.

Kompania kishte përpiluar shënimet shpjeguese si pjesë përbërëse e pasqyrave financiare, megjithatë informacioni i dhënë nga kompania në shënimet shpjeguese nuk ofron detaje në lidhje me: klasifikimin e stokeve për vlerën totale 1,506,405€, burimin e financimit të granteve në vlerë 27,668,782€, lidhur me shlyerjet e pasurive të patundshme në vlerë 1,176,234€, shpenzimet e interesit dhe transferet 136,026€ si dhe parapagimin e tatimit në pronë në vlerë 93,015€.

Kjo kishte ndodhur për shkak se zyrtarët e kompanisë i kishin konsideruar si të mjaftueshme informacionet e prezantuara në shënimet shpjeguese.

**Ndikimi** Mosparaqitja e plotë e shënimeve shpjeguese, shkakton paqartësi në kuptueshmërinë e informatave, si dhe ndikon që informacionet financiare të mos jenë mjaftueshmërisht të plota për përdoruesit e pasqyrave financiare.

**Rekomandimi A5** Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që shënimet shpjeguese, përmbajnë parimet bazë që përdoren për hartimin e pasqyrave financiare dhe informacionet mbi përbërjen e zërave të pasqyrave, janë dhënë sipas kërkesave të standardeve të kontabilitetit.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)**

Me gjerësisht shih Shtojcën I

#### **Çështja A6 - Prezantim jo i saktë i parapagimeve**

**Gjetja** Paragrafi 4.44 Kornizës Konceptuale, specifikon se një pasuri njihet në pasqyrën e pozicionit financiar kur është e mundur që përfitime ekonomiketë ardhshme do të hyjnë në njësinë ekonomike dhe kosto ose vlera e pasurisë mund të matet me besueshmëri.

Kompania në pasqyrën e pozicionit financiar kishte prezantuar parapagimet dhe të arkëtueshmet tjera në vlerë 323,351€ mirëpo ne kemi identifikuar se vlera e tyre nuk ishte e saktë për 28,450€.

Kjo kishte ndodhur për shkak se zyrtarët e kompanisë nuk kishin regjistruar fare faturat e tatimit në pronë për Komunën e Prishtinës për vitin raportues.

**Ndikimi** Mos regjistrimi i faturave në periudhën raportuese ka ndikuar në prezantim jo të saktë të parapagimeve.

**Rekomandimi A6** Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që vlerat e prezantuar në pasqyrën e pozicionit financiar të jenë të sakta për llogaritë përkatëse duke përfshirë të gjitha faturat.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B1 - Mos prezantim i saktë i llogarive të pagueshme****Gjetja**

Sipas Ligjit Nr. 06/L- 032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim neni 12 përkatësisht pika 1 përcakton se: Shoqëritë tregtare që i nënshtrohen dispozitave të këtij Ligji, verifikojnë të paktën një herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dëshmive të tyre mbështetëse nëpërmjet procesit të inventarizimit.

Për të testuar llogaritë e pagueshme përmes kompanisë kemi dërguar kërkesë për letër konfirmime tek palët e treta. Në gjashtë (6) letër konfirmime të pranura kishte diferenca në mes të saldove të kompanisë dhe furnitorëve përkatës. Kompania kishte prezantuar më shumë obligime se sa kanë konfirmuar furnitorët. Fakti që kompania nuk kishte bërë barazimet periodike me klientët ka rezultuar që për llogaritë e pagueshme të ketë diferenca në 67,773€. Po ashtu, fatura në vlerë totale prej 13,309€ që ka të bëjnë me shpenzimet e ndodhura të vitit 2023 është regjistruar në vitin 2024. Kjo ngjarje ka bërë që llogaritë e pagueshme të vitit 2023 janë nënvlerësuar për shumën 13,309€.

Kjo kishte ndodhur për shkak se kompania nuk kishte bërë procesin e inventarizimit-harmonizimit me klientë në baza periodike.

**Ndikimi**

Mos harmonizimi për të pagueshmet si dhe gabimet në evidencat kontabël kanë ndikuar në prezantim jo të plotë dhe të saktë të llogarive të pagueshme.

**Rekomandimi B1**

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë, që janë marrë veprimet e nevojshme korrigjuese të gabimeve në lidhje me detyrimet në të dhënat kontabël, në mënyrë që të bëhet një prezantim i saktë në pasqyrat financiare. Përveç kësaj, të krijohen mekanizma që regjistri i obligimeve të rishikohet në baza të rregullta kohore në mënyrë që të vërtetohet plotësia dhe saktësia e listës së detyrimeve ndaj furnitorëve.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)**

Me gjerësisht shih Shtojcën I

## 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja A7 - Pranimi i dokumente pas mbylljes së konkursit publik

#### Gjetja

Udhëzimit Administrativ 07/2017, neni 5, pika 1.9, përcakton se aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.

Po ashtu konkursi me nr. protokoli 2047 përcakton se kandidatët të kenë së paku një vit përvojë pune, e cila duhet të dëshmohet me pasqyrë të trustit.

Gjatë auditimit të procesit të rekrutimit për tri pozita të shpallura në konkurse të ndryshme (kontabilist, zyrtar i lartë në shërbimin e faturimit dhe inspektor në shërbimin për kontroll dhe shkyçje) kemi vërejtur se kompania kishte pranuar dokumente pas datës së mbylljes së konkurseve.

Dokumentet e pranuar ishin si përvoja e punës, certifikata e lindjes, certifikata që nuk është nën hetime.

Për pozitën "kontabilist" kandidati nuk kishte ofruar dëshminë e përvojës së punës (trustin) siç kërkohej në shpallje të konkursit. Meqenëse kompania kishte mundësuar që kandidatët të ofrojnë dokumente shtesë, në rastin konkret kandidati kishte ofruar dëshminë e përvojës së punës jo të plotë dhe përkundër kësaj kompania kishte nxjerrë aktvendim për themelimin e marrëdhënies së punës.

Kjo kishte ndodhur, për shkak se zyra e personelit nuk kishte trajtuar qartë kërkesat e udhëzimit administrativ të cilat kanë rezultuar edhe me pranim të dokumenteve shtesë.

#### Ndikimi

Mos aplikimi i procedurave të konkursit të publik, mund të diskriminojë personat tjerë potencial për avancime si dhe zbeh kredibilitetin e punësimit në kompani.

#### Rekomandimi A7

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që me rastin e zhvillimit të procedurave të rekrutimit të respektoj kërkesat e parapara me rregullativen ligjore.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

**Çështja A8 - Shpërblimi me kontratë i operatorit të papërgjegjshëm****Gjetja**

Në dosjen e tenderit Autoriteti Kontrajtues do të deklaron të gjitha informatat relevante për kontratën në fjalë që Operatorët Ekonomik të interesuar duhet të dinë për përgatitjen e tenderëve pa kërkuar informata shtesë. Informata të tilla do të përfshijnë të gjitha specifikimet, kërkesat, kriteret, afatet kohore, metodologjitë, kushtet e kontratës, vizitat në lokacion ose takime para-tenderuese etj. të lidhura me procedurat e dhënies së kontratës. Çdo fjali në dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasi që dosja e tenderit është materiali themelor, në bazë të cilit operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre.

Për projektin "Rehabilitimi dhe Ndërtimi i Ujësjellësit e Kanalizimit në Komunën e Shtimes", me vlerë të kontratës 220,101€, Autoriteti Kontaktues kishte shpërblyer me kontratë operatorin ekonomik jo të përgjegjshëm, pasi që nuk kishte përmbushur kërkesat sipas dosjes së tenderit për kapacitetin teknik dhe profesional.

Kërkesa ishte që së paku një (1) udhëheqës të punimeve duhet të jetë inxhinier i diplomuar drejtimi hidroteknik ose konstruktiv, sipas sistemit të para-Bolonjës ose Master i shkencave sistemi i Bolonjës, me përvojë së paku 3 vjeçare me evidencë kopje të noterizuar të diplomës ose, nëse kjo nuk është e mundur, një kopje të diplomës bashkë me një deklaratë të përgatitur dhe nënshkruar nga inxhinieri, përmes së cilës inxhinieri deklarohej se do jetë i angazhuar në këtë projekt -kontratë nuk ishte respektuar pasi që operatori kishte sjell diplomë Bachelor dhe jo sipas kërkesave të dosjes së tenderit.

Kjo kishte ndodhur për shkak se zyra e prokurimit përkatësisht komisioni i vlerësimit të tenderëve nuk kishte vlerësuar me saktësi tenderin dhe mungesës së mjaftueshme të monitorimit nga zyra e prokurimit.

**Ndikimi**

Shpërblimi me kontratë i operatorit ekonomik të papërgjegjshëm, përveç që pasqyron trajtim jo të barabartë, rritë rrezikun që operatori ekonomik të mos realizon kontratën sipas kushteve të përcaktuara në dosjen e kontratës.

**Rekomandimi A8**

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që të ndërmerren veprime duke shtuar kontrollet në procesin e vlerësimit të tenderëve dhe po ashtu mbikëqyrje më të lartë ndaj zyrës së prokurimit në mënyrë që aktivitetet e prokurimit të zhvillohen duke respektuar në plotëni kërkesat që dalin nga dosja e tenderit, përkatësisht ligji i prokurimit.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)****Çështja B2 - Mungesa e kontratave me konsumatorë për shërbimet e ujit****Gjetja**

Ligji nr. 06/L-088 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit neni 24, përcakton që ofruesi i shërbimeve duhet të lidhë kontratë me secilin konsumator ku përcaktohen kushtet e përgjithshme sipas të cilave do t'u ofrohen shërbime konsumatorëve.

Kompania nuk kishte lidhur kontrata me të gjithë konsumatorët që marrin shërbimet e ujit. Sipas regjistrit të konsumatorëve kompania ofron shërbime për 187,010 konsumatorë ndërsa kishte lidhur kontrata vetëm me 110,287 apo 59% të numrit total. Krahasuar me vitin paraprak kemi një rritje të numrit të kontratave të lidhura me konsumatorë (70,242 kontrata apo 42% e numrit total të konsumatorëve).

Kjo gjendje është bartur ndër vite dhe ekziston për shkak të mos bashkëpunimit të mjaftueshëm nga ana e konsumatorëve dhe mungesës së veprimeve të duhura nga kompania.

**Ndikimi** Mungesa e marrëdhënies kontraktuese me konsumatorë për shërbimet e ofruara, pamundëson aplikimin e masave ligjore ndaj këtyre konsumatorëve në rast të mos pagesës së borxhit.

**Rekomandimi B2** Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se janë ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura për lidhjen e kontratave me të gjithë konsumatorët ekzistues të cilët janë pa kontrata.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B3 - Regjistri i konsumatorëve jo në përputhje me rregullat e ARRU-së**

**Gjetja** Rregullorja e Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) nr. 03/2016 për kartën e konsumatorit të shërbimeve të ujit në Kosovë, përmbajtja e regjistrit të konsumatorëve parasheh që regjistri i konsumatorëve ndër të tjera duhet të përmbajë: emrin dhe numrin personal të konsumatorit

Në regjistrin e konsumatorëve ekzistojnë 55 konsumatorë të cilët janë evidentuar me përshkrimin "NN" (pa emër dhe mbiemër) dhe shkurtesa të tjera dhe shuma financiare që këta konsumatorë i detyrohen Kompanisë është 58,712€ si dhe 65,740 konsumatorë të cilëve u mungon numri personal.

Kjo kishte ndodhur për shkak se kompania nuk kishte ndërmarrë veprime të mjaftueshme në identifikimin e konsumatorëve edhe pse në planin e veprimit ishte planifikuar të trajtoj këtë çështje.

**Ndikimi** Regjistrimi i konsumatorëve me përshkrimin NN, (pa emër dhe mbiemër) dhe shkurtesa tjera, dhe pa numër personal, përveç që krijon paqartësi, rritë rrezikun që faturimet e tilla për ujin e shpenzuar të bëhen pa adresë të saktë dhe kjo i pamundëson kompanisë të ndërmerr veprimet ligjore për të arkëtuar borxhet e konsumatorëve.

**Rekomandimi B3** Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë, marrjen e masave përmirësuese, në mënyrë që të gjithë konsumatorët e evidentuar me emërtimin “NN” (pa emër dhe mbiemër) dhe shkurtesa tjera të regjistruhen në emër të shfrytëzuesve të shërbimit. Për më tepër, të sigurohet që shumica e debitoreve të evidentuar përcaktohet se cilëve konsumatorë u takon dhe të merren masat e nevojshme për arkëtimin e tyre.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B4 - Mungesa e instalimit të ujëmatësve**

**Gjetja** Sipas rregullores nr. 10/2019 për Standardet Minimale të Shërbimeve të Ujit në Kosovë neni 29 paragrafi 1, përpos në rastet kur është përcaktuar ndryshe me këtë Rregullore, ofruesi i shërbimeve duhet të faturojë konsumatorët në bazë të konsumit të lexuar në ujëmatës.

Ne kemi vërejtur se kompania gjatë vitit 2023 kishte faturuar 477 konsumatorë të cilët nuk kishin të instaluar ujëmatës. Edhe pse kjo çështje ishte ngritur edhe në raportin e vitit të kaluar, kompania nuk kishte arritur të instalojë ujëmatësit.

Kjo kishte ndodhur për shkak se kompania nuk ka ndërmarr veprime të mjaftueshme për instalimin e ujëmatësve për të gjithë konsumatorët edhe përkundër zotimit të potencuar në planin e veprimit.

**Ndikimi** Mos instalimi i ujëmatësve, rrjedhimisht mos faturimi i sasisë së shpenzuar për këta konsumatorë, ndikon në uljen e të hyrave për kompaninë si dhe rritjen e humbjeve të ujit.

**Rekomandimi B4** Bordi i Drejtorëve duhet të ndërmarrë veprime konkrete për instalimin e ujëmatësve për të gjithë konsumatorët në mënyrë që faturimi për ujin e shpenzuar të bëhet mbi bazën e konsumit.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)**

Me gjerësisht shih Shtojcën I

**Çështja A9 - Dobësi në menaxhimin e projekteve për investime kapitale**

**Gjetja** Marrëveshja për financimin të projekteve në mes KRU Prishtina dhe Ministrisë së Ekonomisë (ME), neni 1 përcakton mënyrën e financimit të Projektit, duke përfshirë burimet e financimit, detyrimet ndaj palëve, si dhe monitorimin e përdorimit të mjeteve. Saktësisht neni 8 i marrëveshjet përcakton se, bartja e mjeteve nga ME në llogari të KRU Prishtina do të bëhet pasi të pranohen raportet dhe opinionin e rregullsisë së projektit nga Njësia e Auditimit të Brendshëm të KRU Prishtina.



Marrëveshja e nënshkruar në vitin 2023 për financim të projekteve në mes Ministrisë së Ekonomisë dhe KRU Prishtina në vlerë prej 440,000€ përcakton që 3 (tre) projekte të realizohen me mjetet e ME. Projektet e planifikuara me mjetet e ministrisë ishin:

- Rehabilitimi i kanalizimit në 10 fshatra të Komunës së Shtimës në vlerë prej 190,000€;
- Rehabilitimi dhe ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Kishnicë të Komunës së Graçanicë në vlerë prej 100,000€;
- Rehabilitimi dhe vazhdimi i ndërtimit të rrjetit të ujësjellësit në fshatrat Bellopojë, Llugë, Orllan dhe rrethinë të Komunës së Podujevës në vlerë 150,000€.

KRU Prishtina nuk kishte respektuar kushtet e marrëveshjes për financimin e projekteve si, përmbushje të afateve kohore në realizimin e kontratës, përzgjedhje të operatorit të përgjegjshëm, ndryshimi i kushteve njëanshëm nga KRU e tjera, të cilat i kishte evidentuar edhe njësia e auditimit të brendshëm. Prandaj si rrjedhojë e kësaj, KRU Prishtina kishte përfituar vetëm 67,658€, për projektin për “Rehabilitimi dhe Ndërtim të Rrjetit të Ujësjellësit në fshatin Kishnicë”.

Kjo kishte ndodhur, pasi që përgjegjësit për zbatimin e marrëveshjes/kontratave nuk kishin bërë menaxhim dhe raportim të duhur të projekteve.

#### **Ndikimi**

Mos respektimi i kushteve të marrëveshjes, ka ndikuar që kompania t'i humb fondet e ndara, dhe financimin e këtyre projekteve t'a bëjë me mjetet e saj vetanake.

#### **Rekomandimi A9**

Bordi i Drejtorëve duhet të ndërmerr veprime në monitorim ndaj personelit/departamenteve brenda kompanisë në mënyrë që projektet të realizohen sipas kërkesave të marrëveshjes.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja A10 - Mos paisja e gjitha stoqeve me kode përkatëse**

##### **Gjetja**

Rregullorja për menaxhimin e depoz, neni 12, përcakton se të gjithë artikujt në depo duhet të kenë kodin/shifrën identifikuese në bazë të të së cilës bëhet regjistrimi dhe futja e të dhënave për artikullin në softver. Artikulli duhet të ketë vetëm një shifër dhe ajo shifër duhet të lidhet vetëm me një emërtim të artikullit.

Gjatë vëzhgimit të procesit të inventarizimit të stoqeve kemi identifikuar se artikujt nuk ishin të ndarë në kode të veçanta, pra në një kod ishin të përfshira më shumë se një artikull. Për më tepër, në disa raste ishin artikujt funksional dhe artikuj jashtë funksionit të përfshira në një kod.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së veprimeve konkrete nga menaxhmenti i kompanisë për të rregulluar çështjen e regjistrimit të inventarit. Edhe pse një kërkesë e tillë për hapjen e kodeve të reja për secilin artikull ishte bërë edhe nga depoisti por nuk ishte marrë parasysh nga personeli përgjegjës për këtë.

#### **Ndikimi**

Mos paisja e secilit artikull me kode përkatëse ka ndikim në mos evidentimin e saktë të listës së stoqeve dhe dalja nga stoku mos të këtë lidhshmëri me artikullin dhe kodin përkatës. Për më tepër, mos trajtimi i stokut jashtë përdorimit ka ndikim në keq menaxhimin dhe keqpërdorimin e stoqeve.

#### **Rekomandimi A10**

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që menaxhimi i depos të bëhet sipas rregullores, duke u paisur secili artikull me kodin përkatës, dhe të ketë politikë për trajtimin e stoqeve jashtë funksionit/ përdorimit.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja A11 - Mangësi në procesin e kalimit të pronësisë për projektet kapitale**

##### **Gjetja**

Bazuar në marrëveshjen e mirëkuptimit në mes të Ministrisë së Ekonomisë dhe KRU Prishtina për kalimin e pronësisë së investimeve kapitale "projekti për ujë dhe kanalizim për zonat rurale të Kosovës faza VI, neni 3, specifikon se përfituesi merr në pronësi dhe menaxhim të plotë dhe pa kurrfarë kufizimesh pasurinë nga Objekti i Marrëveshjes.

KRU Prishtina dhe Ministria e Ekonomisë me datë 13.04.2023 kishin lidhur marrëveshje për kalimin e pronësisë së investimeve kapitale që ndërlidhen me projektin "Projektin për ujë dhe kanalizim për zonat rurale të Kosovës faza VI", në vlerë prej 2,337,102 euro. Investimet kapitale ishin realizuar në fshatrat e komunave: Prishtinë, Drenas, Lipjan, Podujevë. Ky projekt ishte financuar nga Ministria e Ekonomisë dhe nga Qeveria Zvicrrane (CDI).

Kompania edhe pse kishte nënshkruar kalimin e pronësisë për këto investime kapitale, ato i kishte regjistruar si investime në vijim por jo si pasuri në përdorim. Sipas kompanisë projektet e tilla nuk e kishin dokumentacionin e kompletuar dhe gjatë vitit 2023 ishin në proces të kompletimit të dokumentacionit. Megjithatë, ne kemi vërejtur se raporti i CDI (implementues i projektit) me nr. të protokollit 2761 i datës 08.11.2022 pasqyron projektet si të përfunduara.

Për më tepër, KRU Prishtina në pasqyra financiare kishte shpalosur informacione lidhur me këto projekte.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mos monitorimit të duhur gjatë procesit të realizimit projekteve dhe mos analizimit të mjaftueshëm gjatë pranimit të pronësisë së asetëve.

#### **Ndikimi**

Mungesa e monitorimit të projekteve nga kompania gjatë procesit ka ndikuar që kjo çështje të mbetet pezull, dhe pasuritë të trajtohen si investime në vijim dhe jo si pasuri në përdorim. Kjo ndikon që pasqyrat financiare të mos prezantojnë gjendjen e saktë.

**Rekomandimi A11** Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që projektet të monitorohen gjatë procesit të realizimit të kontratës si dhe në rastet e nënshkrimit të marrëveshjeve për kalim të pronësisë projektet të trajtohen në mënyrën e duhur.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)**

Me gjerësisht shih Shtojcën I

**Çështja B5 - Mungesa e identifikimit të pagesave të pranuar nga klientët/konsumatorët e pa identifikuar**

**Gjetja**

Sipas SNK 1, Pasqyrat financiare duhet të pasqyrojnë drejtë pozicionin financiar. Paraqitja e drejtë kërkon paraqitje të besueshme të efekteve të transaksioneve, ngjarjeve dhe kushteve të tjera në përputhje me përkufizimet dhe kriteret e njohjes për pasuritë, detyrimet. Zbatimi i SNRF-ve me dhënie informacionesh shpjeguese shtesë, supozohet të rezultojë në pasqyra financiare të cilat arrijnë një paraqitje të drejtë.

Kompania në regjistrat kontabël ka të regjistruar një shumë financiare prej 663,740 € e cila ishte krijuar si rezultat i pagesave të klientëve/konsumatorëve të pa identifikuar ndër vite. Ne kemi vërejtur se kompania nuk ka të dhëna të sakta lidhur me klientët/konsumatorët e tillë dhe si rrjedhojë kjo vlerë ishte regjistruar në zërin kontabël me përshkrimin “Avanset nga pagesat e paidentifikuara të konsumatorëve”.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e vështirësive në identifikimin e konsumatorëve me rastin e shkarkimit të pagesave nga llogaria bankare. Sipas zyrtarëve përgjegjës, ky është një problem i bartur që nga fillimi i vitit 2003, kur ka filluar të mbahet në analitikë gjendja e konsumatorëve.

**Ndikimi**

Mos identifikimi i klientëve të cilët kanë paguar në llogari të kompanisë, rritë rrezikun që obligimet e konsumatorëve ndaj kompanisë të mos jenë të sakta, dhe klientët të paguajnë më shumë apo më pak sesa është borxhi faktik.

**Rekomandimi B5**

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë, që janë marrë veprimet e duhura për të identifikuar konsumatorët të cilët kanë kryer pagesa në mënyrë që kjo të reflektoj në kartelat individuale të tyre.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.3.1 Kontrollat e brendshme në raportimin financiar

Çështjet tjera që kanë që ndërlidhen me kontrollat e brendshme në raportimin financiar i shpalosim në vijim.

#### Çështja A12 - Mungesë e llogarisë së veçantë për tatimin në pronë

##### Gjetja

Bazuar në Kornizën Konceptuale pika 4.3 përcakton se Paraqitja e elementëve në pasqyrën e bilancit dhe në pasqyrën e të ardhurave bëhet nëpërmjet një procesi që quhet nën-klasifikim.

Kompania nuk kishte një llogari të veçantë për detyrimet ndaj tatimit në pronë për njësitë e saj. Regjistrimi i tyre ishte bërë në kuadër të llogarisë së furnitorit (komunës) përkatëse duke i përfshirë të gjitha transaksionet me njësinë në total. Kështu që, ne e kishim të pamundur të testojmë saldon fillestare dhe përfundimtare të tatimit në pronë. Pra, kompania nuk mbanë evidence kontabël për detyrimet ndaj tatimit në pronë por vetëm në rastet e pranimit të faturave, kompania e kryen pagesën.

Kjo kishte ndodhur për shkak që zyrtarët e financave kishin konsideruar si të mjaftueshme një paraqitje dhe regjistrim të tillë.

##### Ndikimi

Mungesa llogarisë së veçantë për obligimet ndaj tatimit në pronë, ndikon në mos prezantim të qartë të informacionit financiar për detyrimet ndaj tatimit në pronë në pasqyra financiare.

##### Rekomandimi A12

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që regjistrimi i shpenzimeve dhe obligimeve të bëhet sipas kodeve dhe llogarive përkatëse ashtu siç kërkohet.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

### 2.3.2 Llogaritë e arkëtueshme

Vlera e llogarive të arkëtueshme, e prezantuar në PFV ishte 4,356,019€ (vlera neto). Ato kanë të bëjnë me faturimet ndaj konsumatorëve nga afarizmi i rregullt i Kompanisë. Kemi testuar 50 mostra për teste substanciale në vlerë bruto 209,501€.

#### Çështja A13 - Akumulimi i llogarive të arkëtueshme

##### Gjetja

Ligjit për Marrëdhënie të Detyrimeve neni 360 paragrafi 1 përcakton se shërbimet e ujësjellësit për konsumatorët shtëpiak-amvisëri janë kërkesa që parashkruhen pas një viti ndërsa pas tri viteve për bizneset dhe institucionet.

Sipas të dhënave të Kompanisë, nga totali i të arkëtueshmeve tregtare bruto prej 52,231,091€, kemi identifikuar se 48,624,824€ janë borxhe më të vjetra se një vit, ndërsa prej tyre 45,582,833€ me të vjetra se tri vite të cilat ishin të provizionuara.

Gjatë vitit 2023 Kompania kishte iniciuar në procedurë përmbartimore 1,720 raste në vlerë prej 903,026€. Kompania ka gjithsej 605 (129 gjatë vitit 2023) raste të procedurave përmbartimore që janë prapësuar në gjykatë në vlerë totale 937,804€. Po ashtu, vendim të formës së prerë nga gjykata gjatë vitit 2023 janë parashkruar 29 raste në vlerë 45,065€.

Akumulimi i borxheve të klientëve ka ardhur për shkak se Kompania nuk ka ndërmarrë hapat e duhur për arkëtimin e tyre apo nuk ka ndërmarr hapat ligjor me kohë ashtu që të parandalojë parashkrimin e borxheve.

##### Ndikimi

Borxhet e tilla të vjetra potencialisht mund të parashkruhen dhe Kompania nuk do të jetë në gjendje t'i arkëtojë, rrjedhimisht kjo ndikon në realizimin e objektivave të saj.

##### Rekomandimi A13

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që Kompania po ndërmerr me kohë veprimet ligjore që parandalojnë parashkrimin e borxheve.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 2.3.3 Shpenzimet operative

Shpenzimet operative ishin 3,651,473€, të cilat kanë të bëjnë me shpenzime të rrymës, naftës dhe të tjera.

#### Çështja A14 - Pranimi i furnizimeve pa raport të komisionit të pranimit

**Gjetja** Rregullorja brendshme për procesin e blerjeve pa prokurim dhe ekzekutimi i pagesave për blerjet me dhe pa prokurim, neni 13 përcakton, se secila pagesë do ti ketë të gjitha dokumentet e bashkangjitura , ndër të tjera edhe raportin e pranimit nga komisioni për pranimin e furnizimeve ose punëve të kryera.

Gjatë vitit 2023, kompania kishte pranuar furnizime me 5,000 litra naftë për pikën në Badovc në vlerë prej 6,660€. Pranimi i furnizimeve ishte bërë vetëm përmes fletë dërgesës nga ana e shefit të njësisë por pa raport të pranimit nga ana komisionit. Për këtë arsye, edhe nuk ishte çertifikuar pagesa për një kohë nga zyrtari certifikues i kompanisë. Megjithatë, në fund të vitit kompania kishte formuar një komision për verifikim të naftës dhe komisioni në fund vit kishte konstatuar mungesë të 3,517 litra naftë.

Kjo kishte ndodhur për shkak se menaxhmenti nuk kishte formuar komisionin për pranim të mallit i cili duhet t'i bashkangjitet dokumentacionit të lëndës.

**Ndikimi** Mungesa e kontrollit të brendshëm lidhur me furnizimin me derivate ka ndikuar që komisioni në fund vit të konstatoj mungesë të sasive të naftës.

**Rekomandimi A14** Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që në rastet e pranimit të mallit të formoj komisione përkatëse për të monitoruar furnizimin me derivate.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)


### 3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2022 të kompanisë KRU Prishtina sh.a ka rezultuar në 10 rekomandime kryesore. Ndërmarrja kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna.

Kompania kishte bërë përmirësime duke bërë regjistrime të disa pasurive, kishte trajtuar grantet, trajtimin e investimet në vijim, barazimet e regjistrit të stoqeve dhe aprovimin e pasqyrave financiare.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2023, 5 rekomandime janë zbatuar; dhe 5 nuk janë zbatuar, siç është paraqitur në Grafikon më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën në vijim:

**Grafiku 1. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**



**Tabela 1 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak**

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve duhet të ndërmerr veprime konkrete për të azhurnuar regjistrin e pasurive duke i regjistruar pasuritë në vlera të sakta dhe të siguroj që pasuritë të cilat nuk i ka në regjistra, të regjistrohen në mënyrë që vlera e pasurive afatgjata të prezantohen drejtë dhe saktë në pasqyrat financiare.	Kompania kishte implementuar këtë rekomandim, pasi që ishin gjetur regjistrimet e dyfishta dhe ishin bërë korrigjimet.	I zbatuar
2.	Baza për konkluzion	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë, që janë marrë veprimet e duhura për të identifikuar konsumatorët të cilët kanë kryer pagesa në mënyrë që kjo të reflektoj në kartelat individuale të tyre.	Kompania vazhdon të ketë konsumatorë të pa identifikuar për pagesat e bëra.	Nuk ka filluar zbatimin

3.	Kontrollet e brendshme në raportimin financiar	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se pasqyrat financiare janë përgatitur, aprovuar dhe publikuar në afatet e paracaktuara ligjore.	Kompania kishte implementuar këtë rekomandim. Kompania ka aprovuar pasqyrat financiare sipas afateve ligjore.	I zbatuar
4.	Pasuritë afatgjata	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë, që të bëhet identifikimi i të gjithë projekteve të cilat janë në proces të investimit si dhe të prezantohen drejtë në pasqyrat financiare.	Kompania kishte arritur të rregulloj investimet në vijim dhe konsideroj që rekomandimi është i zbatuar	I zbatuar
5.	Pasuritë afatgjata	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë, që regjistri i stoqeve të rishikohet çdo fund vit në mënyrë që prezantimi i stoqeve të jetë i drejtë në pasqyrat financiare.	Kompania gjatë vitit kishte arritur të bëjë harmonizimin rregullimin e stoqeve në depo andaj konsideroj që rekomandimi është i zbatuar.	I zbatuar
6.	Detyrimet afatshkurta	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë, që janë marrë veprimet e nevojshme korrigjuese të gabimeve në lidhje me detyrimet në të dhënat kontabël, në mënyrë që të bëhet një prezantim i saktë në pasqyrat financiare. Përveç kësaj, të krijohen mekanizma që regjistri i obligimeve të rishikohet në baza të rregullta kohore në mënyrë që të vërtetohet plotësia dhe saktësia e listës së detyrimeve ndaj furnitorëve.	Kompania edhe përkundër angazhimit për të bërë harmonizimin në mes të kompanisë dhe furnitorëve nuk kishte arritur të zbatoj në tërësi rekomandimin.	Nuk ka filluar zbatimin
7.	Detyrimet afatshkurta	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë, se janë marrë veprimet e nevojshme korrigjuese në mënyrë që të identifikohen të gjitha pasuritë e financuara nga grantet si dhe të bëhet shpalosja e tyre në pasqyrat financiare me të gjitha kërkesat sipas standardit.	Kompania kishte impementuar këtë rekomandim, duke marrë vendim për fshirjen e tyre nga ana e Bordit të Drejtorëve, pasi që nuk kishin mundësi t'i lidhin me pasuritë e financuara nga grantet, ndërsa për një pjesë kishin siguruar dëshmi se nuk ishin përfituar.	I zbatuar



8.	Të hyrat	Bordi i Drejtorëve duhet të ndërmarrë veprime konkrete për instalimin e ujëmatësve për të gjithë konsumatorët në mënyrë që faturimi për ujin e shpenzuar të bëhet mbi bazën e konsumit.	Kompania nuk kishte arritur të zbatoj rekomandimin dhe ende ekzistojnë mangësi të tilla.	Nuk ka filluar zbatimi
9.	Të hyrat	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë, marrjen e masave përmirësuese, në mënyrë që të gjithë konsumatorët e evidentuar me emërtimin "NN" (pa emër dhe mbiemër) dhe shkurtesa tjera të regjistrohen në emër të shfrytëzuesve të shërbimit. Për më tepër, të sigurohet që shuma debitore e evidentuar përcaktohet se cilëve konsumatorë u takon dhe të merren masat e nevojshme për arkëtimin e tyre.	Kompania nuk kishte arritur të korrigjoj në tërësi dhënat e konsumatorëve. Pra në regjistrin e kompanisë ende ekzistojnë konsumatorë të cilët janë evidentuar me përshkrimin "NN" dhe shkurtesa tjera.	Nuk ka filluar zbatimi
10.	Të hyrat	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se përkundër vështirësive në arritjen e këtij objektivi, janë ndërmarrë të gjitha veprimet për lidhjen e kontratave me të gjithë konsumatorët ekzistues të cilët janë pa kontrata.	Kompania nuk ka arritur të lidhë kontrata me gjithë konsumatorët.	Nuk ka filluar zbatimi

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Naser Arllati, Ndhmës Auditor i Përgjithshëm



Mehmet Mucaj, Drejtor i Auditimit



Valmira Jonuzi, Udhëheqëse e ekipit



Alban Shatri, Anëtar i ekipit



Arbresha Grainca, Anëtare e ekipit



## Shtojca I: Letër konfirmimi / Komentet e NP-së në gjetjet e raportit të auditimit

Çështja	Komenti i NP-së	Pikëpamja e ZKA-së
Dobësi në regjistrin e pasurive	<p>Nuk pajtohem me gjetjen, pasi qe trajtimi i asetëve është bërë në harmoni të plotë me SNK 16.</p> <p>SNA 16 në paragrafin 29 qartazi e definon se: “Një njësi ekonomike do të zgjedhë ose modelin e kostos në paragrafin 30 ose modelin e rivlerësimit në paragrafin 31 si politikë kontabël të vet dhe do të zbatojë këtë politikë për të gjithë kategorinë e aktiveve afatgjata materiale.”(shih ref A1.1).</p> <p>Asetet me kosto 0€, sic mund ta shihni edhe ne listen e bashkangjitur ( Ref A1.2), këto asetë bazuar edhe në përshkrim do ta kishin pasur në kohen e vet një kosto të ulët, por edhe ashtu shumica ë këtyre asetëve janë nga vitit 2007 që nënkupton se efekti i tyre në pasyra është plotësisht i pa përfshillshëm dhe nuk ka thujse asnjë ndikim në PFV.</p> <p>Cështja e përshkrimit të njësisë matëse është një cështje teknike e cila mund të korrigjohet por nuk ka absolut asnjë ndikim financiar.</p> <p>Sic dihet Ndërmarrja e ka për përcaktuar në rregulloret e brendëshme se e aplikon Modelin e Kostos në përputhje të plotë me SNK 16, kjo gjë është e cekur qartazi edhe ne Pasqyra Financiare dhe për transparence janë bërë edhe shpalosje lidhur me asetet që janë në përdorim dhe kanë vlerë në libra 0€ . Për këtë arsye kjo gjetje nuk qëndron pasi gjetja është bërë duke aluduar bazën e rivlerësimit, e të cilën nuk e aplikon Ndërmarrja duke respektuar në plotni SNK 16.</p>	<p>Sa i përket përzgjedhjes së modelit, ajo përcaktohet me politikat e kompanisë dhe çështja nuk është trajtuar nga natyra e përcaktimit të modelit të njohjes së aktivitetit por nga aspekti i trajtimit të aktiveve sipas modelit të kostos.</p> <p>E gjetura qëndron. Fakti që këto pasuri janë të përfshira në regjister dhe janë në përdorim, dhe entiteti gjeneron përfitime ekonomike nga përdorimi i tyre, ne konsiderojmë që menaxhmenti duhet të trajtoj dhe të gjej mënyra të trajtimit të mëtutjeshëm të atyre pasurive si dhe ato duhet të kenë një vlerë financiare. Në kuadër të këtij regjistri përfshihen edhe pasuritë si: shtëpia e pompave me rezervar 20m<sup>3</sup> (sipas regjistrit shihet se zhvlerësimi vjetor ishte 2.5%), stacioni i vjetër i transformatorit elektrik (sipas regjistrit shihet se zhvlerësimi vjetor ishte 2.5%), transformator elektrik 35KV /690V, rrjeti i kanaleve në FPU, kamion kiper FAP 1921, kamion iveco turbo zeta, kamion mercedes etj. Po ashtu, Ligji për Raportim Financiar neni 12 pika 3. përcakton se nëse për shkak të rrethanave të ndryshme, gjendja fillestare (historike) e pasurisë nuk posedon dokumente burimore ose inventari i pasurive është i panjohur, vlefshmëria e tyre për qëllime të regjistrimit dhe qëllimeve tatimore vlerësohet nga vlerësues të licencuar vendor apo të huaj të pasurive të patundshme për vlerësim dhe regjistrim të pasurive.</p> <p>Entiteti në komentim ka dhënë një arsyetim, por fakti që ndërtesat janë të rëndësishme për ndërmarrjen, ne konsiderojmë që entiteti do duhej të mbante në regjistra informata të sakta dhe të plota në mënyrë që të kenë njësinë matëse të besueshme</p>

		<p>në regjistër dhe natyrisht që të bëhen edhe krahasime çmim/sipërfaqe. Po ashtu edhe rregullorja e brendshme e entitetit për regjistrim të mjeteve themelore neni 6 përcakton se, pasuritë do të regjistrohen me informata përkatëse si: data, kosto e blerjes, njësia/sasia matëse etj.</p> <p>Meqenëse ndërmarrja ka në regjistër 3510 asete që kanë vlerë zero dhe ato janë në përdorim ku ndërmarrja edhe gjeneron përfitime ekonomike nga përdorimi i tyre. Duke pas parasysh që jeta e dobishme e një aktivi është periudha gjatë së cilës një aktiv pritët të jetë i dobishëm për përdorim nga njësia ekonomike, shumta e amortizueshme e një aktiviteti do të shpërndahet mbi baza sistematike gjatë jetës së tij të dobishme. Prandaj, sipas paragrafit 51 të SNK 16 vlera e mbetur dhe jeta e dobishme e asetit duhet të rishikohet të paktën në çdo fund vit. Meqenëse kompania nuk ka ndërmarr veprime me kohë për jetëgjatësinë dhe ato pasuri i përdorë atëherë entiteti mund të shqyrtoj rishikimin e metodës së llogaritjes së aseteve dhe të përdorë një metodë tjetër të amortizimit ose vlerësimit që reflekton më mirë gjendjen e tyre aktuale.</p>
<p>Mos trajtim i duhur pasurive afatgjata përkatësisht projekteve kapitale</p>	<p>Ky projekt në vete përmban dy komponentë : Rrjetë të Ujësjellësit dhe Pajisjet e Makinerise. Dhe secili element/aset është listuar dhe i është caktuar kategoria se cilës i takon brenda atij projekti. Projekti është kapitalizuar plotësisht dhe kishte vlere pa TVSH 203,826€ (me TVSH me punë shtesë 240,515€). Për referencë të bashkangjitur gjeni asetet kushihet se janë ta kapitalizuara të gjitha elementet e projektit dhe janë ndarë nëpër komponent dhe zhvlerësohet me normat sipas Rregullores në fuqi. (shih ref A2.3).</p>	<p>E gjetura qëndron. Bazuar në rregulloren e juaj, janë kategorizuar asetet në disa kategori ndër të tjera: Rrjetet e ujësjellësit, rrjetat e kanalizimit, kyçjet, pajisjet elektrike, pajisjet e zyreve, mobiljet e zyreve, etj. por nuk janë specifikuar se çka përfshinë secila kategori. Sipas rregullores KRU vlerëson sipas parimit të përgjithshëm të njohjes të gjithë kostot e mjeteve themelore. Këto kosto përshijnë kostot e pësuar fillimisht për të blerë apo ndërtuar, kostot e krijuara për të sjell mjetin themelor në vendin e duhur, pra përfshin çmimin e blerjes dhe të gjitha shpenzimet e nevojshme për futjen e mjetit në prodhim - përdorim (Ref. Rregullorja e KRU faqe 3 mbi regjistrimin dhe</p>

	<p>Ky projekt në vete përmban dy komponentë : Rrjetë të Ujësjetit dhe Rrjetë të Ujërave të Ndotura, Ujematës dhe Pajisjet e Makinerise dhe. Dhe secili element/aset është listuar dhe i është caktuar kategoria se cilës i takon brenda atij projekti.</p> <p>Projekti është kapitalizuar plotësisht dhe kishte vlerë së bashku me punët shtesë 1,047,116€ ). Për referencë të bashkangjitur gjeni asetet kushihet se janë ta kapitalizuara të gjitha elementet e projektit dhe janë ndarë nëpër komponent dhe zhvlerësohet me normat sipas Rregullores ne fuqi. (shih ref A2.4).</p> <p>Ky projekt në vete përmban dy komponentë : Ndëertesa dhe struktura , Rrjetë të Ujësjetit dhe Pajisjet e Makinerise. Dhe secili element/aset është listuar dhe i është caktuar kategoria se cilës i takon brenda atij projekti.</p> <p>Për referencë të bashkangjitur gjeni asetet kushihet se janë ta kapitalizuara të gjitha elementet e projektit dhe janë ndarë nëpër komponent dhe zhvlerësohet me normat sipas Rregullores ne fuqi. (shih ref A2.5).</p> <p>Ky projekt në vete përmban tre komponentë : Ndëertesa dhe struktura , Ujematës dhe Pajisjet e Makinerise. Dhe secili element/aset është listuar dhe i është caktuar kategoria se cilës i takon brenda atij projekti. Për referencë të bashkangjitur gjeni asetet kushihet se janë ta kapitalizuara të gjitha elementet e projektit dhe janë ndarë nëpër komponent dhe zhvlerësohet me normat sipas Rregullores ne fuqi. (shih ref A2.6)</p>	<p>njohjen e e aseteve afatgjata). Sa i përket ndarjes në pjesë të rëndësishme, ndërmarrja nuk ka politika të shkruara për mënyrën e trajtimit të aseteve të rëndësishme si dhe nuk është e qartë kur një aset klasifikohet i rëndësishëm për tu ndarë nga projekti. Për më tepër, Entiteti mban në regjistër pasuritë me vlerë totale të projektit "Furnizim me uji dhe kanalizim" të cilat ishin të regjistruara si projekte kapitale që përfshijnë të gjitha kostot (ky projekt ishte regjistruar nga viti 2013 dhe jetëgjatësinë sipas regjistrimit e kishte për vite d.m.th. deri në vitin 2023. Për më shumë, ne kemi vërejtur se entiteti kishte bërë korrigjime për një pjesë të pasurive por për projektin në fjalë nuk kishte bërë korrigjimet e nevojshme dhe si rrjedhojë e kësaj i gjithë projekti që në vitin 2013 kishte vlerën 2,869,667 euro në fund të vitit 2023 kishte vlerën zero). Pra, bazuar në sqarimin më lartë entiteti kishte përdorur dy qasja për trajtim të pasurive. Ndërsa për qëllime të caktuar ju mund të mbani evidenca të caktuara ndërsa sa i përket trajtimit të aseteve duhet të hartoni procedura të qarta, të shkruara dhe të aplikoni një politikë konsistente të trajtimit të tyre. Entiteti në emër të këtij projekti kishte bërë 16 regjistrime si, 7 lloje të valvulave i kishte regjistruar ndaras, 5 pjesët fazonike që ndërlidhen me gypat të ndryshëm i kishte regjistruar ndaras dhe 4 gypat te cilat ishin të madhësive të ndryshme i kishte regjistruar ndaras. Pra, ndarja e projektit në pjesë kishte rezultuar që 8 pasuritë e regjistruara ndaras kishin vlerën financiare 2,484 euro (pra, vlera e këtyre 8 pasurive variron nga 67 euro deri ne 560 euro). Për rastet e valvulave nuk ishin kapitalizuar por janë regjistruar sipas pozicionit të përshkruar në paramasë. Pra, valvulave nuk iu është mvesh (kapitalizu) punët tjera ndërsa gypit fi 315 në vlerë 2,842 euro iu është mvesh kapitalizimi. Për më shumë, për dy nën pozicionet të cilat ishin të</p>
--	---	--

Ky proket përmban vetëm një komponent Rrjetë dhe është kapitalizuar plotësisht në atë kategori me vlerë totale prej 17,816€ ( shih doc A2.7).

Me qëllim të menaxhimit më të mire dhe dukë pasur parasysh që mund të ketë zhvillime në vazhdimësi nëpër modulet përkatëse është konsideruar më e pershtatshme të ndahen modulet, dhe as këtu nuk ka asnjë ndikim financiar pasi që janë në kategoritë përkatëse. Ky proket përmban vetëm një komponent Rrjetë dhe është kapitalizuar plotësisht në atë kategori me vlerë totale prej 429,557€ ( shih doc A2.8).

Vlera e specifikuar është si pozicion të Projektit Fushe Kosova 1 dhe 2 (e cila ishte pjesë e Prishtina Faza II) e cila kishte vlerën totale të regjistruar në total kostrot tjera të atribueshme në total prej 5,026,666€. Të gjitha këto ishin listuar dhe kategorizuar si Rrjetë, që nga aspekti financiar nuk ka asnjë element që ndikon në PF pasi kategorizimi është i njëjtë rrjedhimisht edhe normat e aplikueshme të zhvlerësimit janë të njëjta . (shih A2.9).

Për licencat pajtohemi se duhet të bëhen korrigjime dhe të kalojnë si shpenzime të periudhes.

Kërkesat ligjore janë dukshëm të qarta, përveq kufizimit nga ana e ligjit të ATK-së, edhe Ligji Për kontabilitet dhe Raportim Financiar qartazi te Neni 20 definon se Dokumentet kontabël në bazë të të cilave janë mbajtur llogaritë ruhen për të paketën pesë (5) vjet.

Thajse cdo informate e mësipërme përfshirë edhe këtë të fundit për asete me vlerë 0 ishin më të vjetra se 5 vite. Për më tepër ZKA në vazhdimësi ka audituar KRU Prishtinën që nga vitit 2017, që

regjistruara ndaras nuk ishte kalkuluar zhvlerësimi vjetor për vitin 2023. (Po ashtu, sipas dëshmimeve ky projekt ishte regjistruar me 31.12.2023 duke kaluar nga investimi në vijim në pasuri në përdorim ndërsa shpenzimet e zhvlerësimi i kishte kalkuluar në 16 pasuritë e këtij projekti për vitin 2022 dhe zhvlerësimi për 2023 e kishte bërë vetëm për 14 pasuritë). Andaj është e pa qartë dhe mënyra e tillë e bën të pa mundur që në vlerësojmë mënyrën e kapitalizimit derisa nuk ka një politikë të qartësuar nga entiteti se në cilat situata (rrethana) përcaktojnë pjesët e rëndësishme për qëllime të regjistrimit të pasurive.

Lidhur me këtë projekt, në rastin konkret pompa zhytëse është regjistruar në vlerë 12,300 euro ndërsa vlera e kësaj pasurie sipas kontratës është 12,711 euro (pa tvsh), prandaj për këtë pozicion nuk shihet se entiteti kishte bërë kapitalizim të punëve përgatitore apo montuese. Për më tepër, ne kemi vërejtur se artikujt me përshkrime pompë zhytëse janë të regjistruara në klasa të ndryshme si klasa g-pajisje të makinerisë dhe H pajisje të mirëmbajtjes. Entiteti nuk ka një politikë të qartësuar se cilat përcaktojnë pjesët e rëndësishme për qëllime të regjistrimit edhe pse norma e zhvlerësimit ishte e njëjtë (10%).

Projekti është ndërtim i gypit ndërsa për këtë projekt janë bërë disa regjistrime d.m.th. edhe janë regjistruar ndaras edhe pjesët tjera përcjellëse të gypit ndaras. Pra, meqenëse kontrata përcakton se ndërtimi i gypit të caktuar atëherë edhe regjistrimi do duhej të ishte i plotë.

Për pjesën tjetër nuk është regjistruar edhe nuk dihet.

Meqenëse në kontratë specifikohet se vetëm mirëmbajtje janë rreth 5000 euro ndërsa pjesa tjetër pasuri. Kështu që në regjistër nuk janë të regjistruara pjesa tjetër.

Komenti i entitetit përshkruan gjendjen e regjistrimit por çështja është

	<p>nënkupton se i ka mbuluar peiudhat me auditim.</p>	<p>trajtuar të mënyra e ndarjes së aseteve. Entiteti ka të kategorizuar si komponentë rrjetat e ujësjellësit ku nuk është e përcaktuar se çka duhet të klasifikohet në këtë komponentë. Po ashtu referuar mostrës si aset është regjistruar vetëm aset me emërtim rrjeta e ujësjellësit. por DMTH deri në 2022 trajtimin e kanë bërë me norma tjera ndërsa prej vitit 2022 kanë ndryshuar rregulloren dhe korrigjimet i kanë bërë retro për 3 vite prapa.</p> <p>Rregullore (MPB) nr. 05/2020 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (MAP) nr. 01/2015 për shenjat unike të klasifikimit të dokumenteve dhe afatet e ruajtjes së tyre përcakton se, Veprimtaria e kontabilitetit dhe Menaxhimi i pasurisë të ruhen në afatin e Përhershëm. Ndërsa neni 57, i Ligjit për TVSH, përcakton se të gjitha regjistrimet dhe dokumentet tjera sikur që kërkohet me nenin 55 dhe 56 të këtij ligji, për periudhën më së paku prej gjashtë (6) viteve, respektivisht prej njëzet (20) viteve për pasurinë e paluajtshme, e cila fillon pas vitit në të cilin ka lindur detyrimi për TVSH, apo pasi që të ketë ndodhur zbritja e TVSH-së apo rregullimi i TVSH-së;</p> <p>Neni 57, i Ligjit për TVSH, përcakton se të gjitha regjistrimet dhe dokumentet tjera sikur që kërkohet me nenin 55 dhe 56 të këtij ligji, për periudhën më së paku prej gjashtë (6) viteve, respektivisht prej njëzet (20) viteve për pasurinë e paluajtshme, e cila fillon pas vitit në të cilin ka lindur detyrimi për TVSH, apo pasi që të ketë ndodhur zbritja e TVSH-së apo rregullimi i TVSH-së;</p> <p>Po ashtu, Neni 12, i Ligjit për raportim financiar, përcakton se nëse për shkak të rrethanave të ndryshme, gjendja fillestare (historike) e pasurisë nuk posedon dokumente burimore ose inventari i pasurive është i panjohur, vlefshmëria e tyre për qëllime të regjistrimit dhe qëllimeve tatimore vlerësohet nga vlerësues të licencuar vendor apo të huaj të pasurive të patundshme për vlerësim</p>
--	---	---



<p>Dobësitë e identifikuar nga raporti i inventarizimit të mjeteve themelore</p>	<p>Nuk e kemi të qartë se çfarë është gjetje në këtë rast dhe është në kundërshtim të plotë me parimet kontabel dhe me Gjetjen B16 nga ZKA për vitin 2021</p> <p>Ndërmarrja me 31.10.2022 ka aprovuar Procedurën për Inventarizim të Mjeteve Themelore, Stoqueve dhe Parasë së Gatshme në të cilën janë të përshkruar hapat që duhet të ndërmerren me qëllim të prezentimit sa më të saktë të gjendjes së pasurive.</p> <p>Gjatë vitit ishin zbatuar në përpikëri kërkesat nga kjo procedurë, dhe pas aprovimit të raportit të inventarizimit nga BD, janë ndërmarrë hapat e nevojshëm në kontabilitet. Dhe sic dihet prezentimi i pasurive bëhet duke u bazuar edhe në konceptin e ekzistencës, në këtë rast asetet të cilat kanë munguar në terren edhe janë shlyer nga regjistrat kontabël me qëllim që prezentimi në Pasqyra Financiare të jete i saktë.</p>	<p>dhe regjistrim të pasurive.</p> <p>E gjetura qëndron.</p> <p>Komenti i entitetit lidhur me prezantimi i pasurive bëhet duke u bazuar në konceptin e ekzistencës. Pikërisht për këtë edhe në mendojmë që është dashur të bëhen hulumtime lidhur me pasuritë që janë konstatuar se mungojnë si dhe të gjendët arsyet tjera mbështetëse dhe pastaj të shikohet mundësia e veprimeve për korrigjime eventuale të regjistrave.</p> <p>Fshirja e pasurive nga regjistrat e kompanisë pa e analizuar shkaqet dhe rrethanat, në konsiderojmë veprim jo të duhur dhe jo në harmoni kërkesat e qeverisjes korporative.</p> <p>Sipas Qeverisjes Korporative të ndërmarrjes, çdo i punësuar ka për detyrë të mbrojë asetet e Ndërmarrjes, duke përfshirë por jo duke u kufizuar në godinat dhe pajisjet fizike, regjistrimet, informatat e konsumatorëve dhe markën e Ndërmarrjes, fshehtësitë e tregut dhe tiparet e tjera intelektuale, duke u siguruar që, pa marrë parasysh kush është përdoruesi, asetet e tilla duhet të shfrytëzohen në mënyrë të duhur dhe efikase vetëm për të mirën e Ndërmarrjes. Po ashtu, Qeverisja përcakton se përdorimi i pautorizuar, keqpërdorimi, ngatërrimi ose mos kujdesja kanë ndikim direkt në profitin e Ndërmarrjes. Të gjitha asetet e Ndërmarrjes duhet të përdoren për qëllime legjitime të biznesit.</p>
<p>Prezantim jo i plotë i shënimeve shpjeguese</p>	<p>Ndërmarrja ka prezentuar Pasqyrat Financiare dhe shpalosje në harmoni me kërkesat bazë nga Standardet Ndërkombëtare dhe Korniza Ligjore e aplikueshme, dhe nuk ka reference/kriter të bazuar lidhur me këtë kërkesë.</p> <p>Një kërkesë e tillë asnjehere nuk është parashtruar, dhe nuk është diskutuar sic edhe kërkon SNISA</p>	<p>E gjetura qëndron. SNK 1 Shënimet shpjeguese duhet të paraqiten në mënyrë sistematike, për sa kohë që kjo është e mundur. Çdo zë në bilancin kontabël, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe në pasqyrën e fluksit monetar duhet të referohet me informacionin përkatës në shënimet shpjeguese.</p> <p>Pika 11 - Shënimet shpjeguese</p>



	<p>1260” Komunikimi me të ngarkuarit me qeverisje”.</p> <p>Gjithësesi nëse një element i tillë mbështetet më fakte ne mund ta përmbledhim këtë informacion dhe t'i bashkangjitet pasqyrave së bashku me raportin e Auditimit sic edhe lejojnë Srandardet Ndërkombëtare të Auditimit .</p>	<p>përmbajnë informacion shtesë të atij të paraqitur në bilancin kontabël, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e fluksit monetar. Shënimet shpjeguese japin një përshkrim tregues ose detajim të zërave të paraqitur në këto pasqyra dhe informacion lidhur me zërat që nuk janë kualifikuar për njohje në këto pasqyra. Sipas SNK 1 Pika 75, inventarët ndahen në nënklasa në përputhje me SNK 2. Sipas SNK 2 , pika 36 në pasqyrat financiare duhet të jepet informacion shpjegues për: b ) vlerën kontabël totale të inventarëve dhe vlerën kontabël sipas klasifikimeve që janë të përshtatshme për njësinë ekonomike; d) shumën e inventarëve të njohura si shpenzim gjatë periudhës; e) Informacioni për vlerat kontabël të mbajtura në klasifikime të ndryshme të inventarëve dhe shkalla e ndryshimeve në këto aktive është i vlefshëm për përdoruesit e pasqyrave financiare. Po ashtu, SNK 20 dhënia e shënimeve shpjeguese, pika c politika kontabël e përdorur për grantet qeveritare, përfshirë metodat e përdorura të paraqitjes në pasqyrat financiare; b) natyra dhe madhësia e granteve qeveritare të njohura në pasqyrat financiare dhe një tregues për format e tjera të ndihmës qeveritare prej të cilave njësinë ekonomike ka përfituar drejtpërsëdrejti; dhe SNK 16 Në pasqyrat financiare duhet të jepet informacion shpjegues për çdo kategori të aktiveve afatgjata materiale: shtesat; (ii) aktivet e klasifikuara si të mbajtura për shitje ose të përfshira në një grup për t'u nxjerrë jashtë përdorimit të klasifikuara si të mbajtura për shitje në përputhje me SNRF 5 dhe nxjerrjet e tjera jashtë përdorim.</p>
--	---	---

<p>Mos prezantim i saktë i llogarive të pagueshme</p>	<p>Nuk pajtojem me nje pjesë te gjetjes</p> <p>Sic dihet konfirmimi nga Palët e Treta është mjet i auditorit i cili lehtëson kryerjen e auditimit, megjithatë një mos përputhje e tillë nuk përben gjetje, së paku për një vlerë të caktuar të kësaj diference. Kjo pasi që diferenca kryesore ka ardhur nga një kompani ( Kompania F. Me te cilën kishim diferencë 56,028€), për të cilën ne e kemi konfirmuar se i kemi dëshmitë të cilat mbështesin saldon e paraqitur/akumuluar nga ana e jone, në këtë mënyrë mund edhe mund të konfirmohet saktësia e saldosit së obligimeve.</p>	<p>E gjetura qëndron. Bazuar në Standardet e Kontabilitetit, ekzistojnë konfirmimet pozitive dhe negative, të cilat janë nga palët e treta. Këto konfirmime nga palët e treta konsiderohet të besueshme për shkak të krahasimeve. Meqenëse kishte diferencë në mes regjistrit të KRU dhe furnitorit, entiteti nuk kishte bërë harmonizime me furnitorin siç kërkohet me rregullativën ligjore.</p> <p>Sipas SNA500 Evidenca e nevojshme te Auditimit, një konfirmim me të tretët përfaqëson një evidence auditimi të siguar nga audituesi si një përgjigje e drejtpërdrejtë në formë të shkruar, e dhënë për audituesin nga një palë e tretë (pala konfirmuese).</p>
<p>Mungesa e instalimit të ujëmatësve</p>	<p>Ndërmarrja në vazhdimësi ka trajtuar këtë pikë, dhe ka instaluar ujëmatësit tek të gjithë konsumatorët. Për pjesën e mbetur është e dëshmuar se edhe Ndërmarrja ka kryer furnizimet dhe ka ndërmarrë hapa për instalimin e ujëmatësve të konsumatorët e mbetur, kjo ishte e pamundëshme për shkak teknike në hapsirat e konsumatorëve, për këtë edhe janë përgatitur raporte nga personat përgjegjës dhe mund të dëgohen.</p>	<p>E gjetura qëndron. Entiteti ka dhënë një arsyetim të cilin veç se ne e kishim gjatë auditimit.</p>

<p>Mangësi në procesin e kalimit të pronësisë për projektet kapitale</p>	<p>Ndërmarrja ka bërë raportimin në harmoni me kërkesat e parimeve të kontabilitetit, duke u bazuar në kërkesat ë mëposhtme:</p> <p>Gjatë raportimit ne kemi zbatuar në plotni kërkesat nga Korniza Konceptuale për Raportim Financiar i cili në paragrafin 4.6 definon “Gjatë vlerësimit nëse një zë e plotëson përkufizimin e një aktivi, pasivi apo kapitali neto, duhet ti kushtohet vëmendje përmbajtjes themelore të tij dhe realitetit ekonomik dhe jo vetëm formës së tij ligjore.”. Pas nënshkrimit të marrëveshjes janë bërë verifikimet e nevojshme, të cilat kanë dëshmuar se projektet nuk kanë përfunduar dhe nuk kanë pranim teknik, përkatësisht në si KRU ende nuk kemi përfitime ekonomike, për me tepër ne marrëveshjen e nënshkruar nuk ceket se projektet janë të përfunduara .</p> <p>Për këtë qëllim përveq prezentimit në Pasqyra Financiare si investime në vijim, ne e kemi dhënë sqarimin në detaje lidhur me situaten me asetet nga këto projekte.</p>	<p>E gjetura qëndron. Bazuar në marrëveshjen e nënshkruar për kalimin e pronësisë së projekteve nga Ministria e Ekonomisë në KRU Prishtina si dhe bazuar në raportin e CDI, projektet ishin të përfunduara. Raporti i CDI specifikon që programi për fazën IV ka filluar në vitin 2018 dhe ka përfunduar në tetor të vitit 2022, pas sigurimit të suksesshëm të furnizimit me ujësjellës të ri dhe të rehabilituar për komunitetin anëmbanë Kosovës duke u dhënë qasje në shërbime të ujësjellësit nga kompanitë. Po ashtu raporti citon se, përfundimi i suksesshëm i programit mundëson KRU-ve të ngrisin numrin e konsumatorëve, përmirësimin e të hyrave, dhe të ofroj shërbime më të mira për qytetaret.</p> <p>Megjithatë, entiteti me 21 qershor 2024 ka përcjellur dëshmi shtesë lidhur me gjendjen e atyre projekteve. Sipas dëshmimeve të ofruara shihet se projektet ende nuk ishin në funksion për arsye të ndryshme. Por është e paqartë se si entiteti që nga fundi i vitit 2022 nuk kishte arritur të trajtojë (finalizojë) projektet e tilla kapitale.</p>
<p>Mungesë e llogarisë së veçantë për tatimin në pronë</p>	<p>Nuk pajtohem me gjetjen, Kompania kishte bërë prezentimet në harmoni me kornizen konceptuale.</p> <p>Nuk është e nevojshme të kemi saldo të tatimit në pronë sepse ashtu sic edhe e kërkon Ligji, KRU paguan rregullisht tatimin në pronë dhe nuk është e pritshme të kemi saldo në fund të vitit lidhur me këto obligime. Pra nuk pritet dhe nuk do të duhej të kemi saldo fillestare apo përfundimtare për obligime tatimore, pasi ato shlyhen në rrjedhen normale te operimit .</p>	<p>E gjetura qëndron. KRU ka llogari të parapagimit për tatimin në pronë vetëm për njësinë në Prishtinë dhe jo për njësitë tjera të saj. Ne konsiderojmë që është e nevojshme për shkak se ne kemi vërejtur që ndërmarrja kishte obligime të vitit paraprak për njësinë e Obiliqit por ai obligim nuk ishte i pasqyruar. Për më tepër, në PVF entiteti nuk ka dhënë shpjegime lidhur me shpenzimet/detyrimet e tatimit në pronë.</p>

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATUMI SAKRATOSKOPËR (SUBMITTED DATE) 15-06-2024			
Klasa Org. Org. Jedin. Org. Unit	Shif. Klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. Ifaqeve Br. Stranica No. Pages
05	47	937	1



KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL SH.A.  
 REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.  
 REGIONALNA KOMPANIJA ZA VODOISPRJEVANJE D. O. O.  
**PRISHTINA**

3296/1

11-06-2024

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Kompanisë Rajonale të Ujësjetjes Prishtina sh. a., për vitin 2023 (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- Nuk pajtohem me trajtimin dhe gjetjet A1, A2, A3, A4, A6, B1, B4 dhe A12 si dhe rekomandimet e dhena për ato gjetje. Së bashku me formular i gjeni qëndrimet tona për të gjitha ato gjetje ku nuk jemi pajtuar. Konsiderojmë se qëndrimet tona dhe trajtimi i çështjeve të ngritura ka qenë të bazuara dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare dhe kornizen ligjore në fuqi
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Bashkim Pllana



Kryesues i Bordit të Kompanisë Rajonale të Ujësjetjes Prishtina sh. a.,

Data: 11.06.2024, Prishtinë.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante.
- <sup>2</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet



PASQYRAT FINANCIARE

PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2023

## Përmbajtja

	Faqe
Deklarata e Pajtuëshmërisë	
Raporti i Auditorit të pavarur	
Pasqyra e pozicionit financiar	1
Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet	3
Pasqyra e rrjedhës së parësë	4
Shënime të pasqyrave financiare	5-30

## Deklarata e Pajtueshmërisë

---

Për Pasqyrat Financiare të vitit të përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Ne deklarojmë se Pasqyrat Financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2023, paraqesin pamje të drejtë dhe të vërtetë të pozitës financiare, rezultateve të operacioneve dhe rrjedhave të parasë dhe që pasqyrat financiare janë përgatitur në pajtim më të gjitha kërkesat ligjore, të *Ligjit Nr. 06L/-032 Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim*.



## PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

Më 31 dhjetor 2023

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

	Shënimet	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022 RISHIKUAR
<b>PASURITË</b>			
<b>Pasuritë afatshkurtëra</b>			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	8	4,641,214	2,833,997
Të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	7	4,356,019	5,129,068
Parapagime dhe të arkëtueshme tjera	7	323,351	158,639
Stoqet	6	1,506,405	1,503,100
<b>Gjithsej pasuritë afatshkurtëra</b>		<b>10,839,108</b>	<b>9,624,804</b>
<b>Pasuritë afatgjata</b>			
Prona, ndërtesa dhe paisjet	4	86,011,967	85,725,967
Pasuritë e paprekshme	5	194,163	232,327
<b>Gjithsej pasuritë afatgjata</b>		<b>86,206,129</b>	<b>85,958,294</b>
<b>GJITHSEJ PASURITË</b>		<b>97,045,237</b>	<b>95,583,098</b>
<b>DETYRIMET DHE EKUITETI</b>			
<b>Detyrimet</b>			
<b>Detyrimet afatshkurtëra</b>			
Detyrimet për kredi afatshkurtër	12	1,510,723	2,540,675
Të pagueshme tregtare dhe të tjera	10	1,189,666	860,766
Detyrimet tjera	11	2,936,574	2,942,427
Provizionet për rastet e kontesteve	11.1	277,064	221,010
<b>Gjithsej detyrimet afatshkurtëra</b>		<b>5,914,027</b>	<b>6,564,878</b>
<b>Detyrimet afatgjata</b>			
Detyrimet për kredi afatgjatë	11	5,180,000	6,653,000
Detyrimet për të hyrat e shtyera	13	27,668,782	30,176,031
<b>Gjithsej detyrimet afatgjata</b>		<b>32,848,782</b>	<b>36,829,031</b>
<b>Ekuiteti</b>			
Kapitali bazë		25,000	25,000
Fitimet e mbajtura		(16,558,712)	(22,224,582)
Fitimi i vitit		1,989,668	1,575,767
Rezerva për korporatizim dhe të tjera		72,826,472	72,813,005
<b>Gjithsej ekuiteti</b>		<b>58,282,429</b>	<b>52,189,190</b>
<b>Gjithsej detyrimet</b>		<b>38,762,809</b>	<b>43,393,909</b>
<b>GJITHSEJ DETYRIMET DHE EKUITETI</b>		<b>97,045,237</b>	<b>95,583,098</b>

Këto pasqyra u nënshkruan në emër të menaxhmentit nga ana e:

Drejtori Ekzekutiv



Drejtori Financiar

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar së bashku me shënimet e paraqitura nga faqet 5 deri 30, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

**PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE**

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023

*(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)*

	Shënimet	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022 RISHIKUAR
Shitjet	14	15,911,861	15,447,625
Kosto e mallit të shitur	15	(1,228,211)	(1,062,372)
<b>Fitimi bruto</b>		<b>14,683,650</b>	<b>14,385,253</b>
Shpenzimet e personelit	16	(6,240,561)	(5,680,746)
Shpenzime operative	17	(3,651,473)	(3,264,934)
Zhvlerësim dhe Amortizim	4,5	(3,115,897)	(3,127,606)
Shpenzime të përgjithshme administrative	17.1	(589,789)	(764,917)
Shpenzime të provizionimit të borxheve	21	(85,538)	(1,236,264)
<b>Total shpenzimet</b>		<b>(13,683,257)</b>	<b>(14,074,466)</b>
<b>Të hyra tjera total</b>	<b>18</b>	<b>1,360,477</b>	<b>1,795,522</b>
Të hyra tjera operative		249,109	620,044
Të hyrat nga grantet		981,815	1,175,478
Të hyrat nga provizionet		129,554	-
<b>Fitimi operativ</b>		<b>2,360,870</b>	<b>2,106,309</b>
Shpenzimet financiare, net	19	(136,026)	(203,955)
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>2,224,844</b>	<b>1,902,353</b>
Shpenzimi i tatimit në fitim	20	(235,176)	(326,587)
<b>Fitimi neto i vitit</b>		<b>1,989,668</b>	<b>1,575,767</b>
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
<b>Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>1,989,668</b>	<b>1,575,767</b>

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse duhet lexuar së bashku me shënimet e paraqitura nga faqet 5 deri 30, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

## PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

	Kapitali bazë	Fitimet e mbajtura	Fitimi i vitit	Rezerva për korporatizim dhe të tjera	Gjithsej
Gjendja më 1 janar 2022	25,000	(11,211,282)	-	72,813,005	61,626,723
Fitimi neto për vitin	-	-	1,575,767	-	1,575,767
Transfer/ Ripasqyrim	-	(11,013,300)	-	-	(11,013,300)
Gjendja më 31 dhjetor 2022 <b>_RISHIKUAR</b>	25,000	(22,224,582)	1,575,767	72,813,005	52,189,190
Fitimi neto për vitin	-	-	1,989,668	-	1,989,668
Transfer/ Ripasqyrim	-	4,090,104	-	13,467	4,103,571
Gjendja më 31 dhjetor 2023	25,000	(16,558,712)	1,989,668	72,826,472	58,282,429

Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet duhet lexuar së bashku me shënimet e paraqitura nga faqet 5 deri 30, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.



## PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

	Shënimet	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022 RISHIKUAR
<b>Fitimi neto për vitin</b>		<b>1,989,668</b>	<b>1,575,767</b>
Rregullime për:			
Zhvlerësim dhe amortizim		3,115,897	3,127,606
Shpenzimet e interesit		136,026	203,955
Shpenzimet e tatimit		235,176	326,587
Shpenzimet e provizionimit		85,538	1,236,264
<b>Fitimi operativ para ndryshimeve të kapitalit punues</b>		<b>5,562,305</b>	<b>6,470,179</b>
<b>Ndryshimet në kapitalin punues</b>			
(Rritja)/Zvogëlimi në stoqe	6	(3,305)	73,648
(Rritja)/(Zvogëlimi) në të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera	7,7.1	510,679	7,195,240
Rritja/(Zvogëlimi) në të pagueshme tregtare dhe të tjera	10,11	87,871	(980,733)
Zvogëlimi/ (Rritja) në provizionet për rastet e kontesteve	11.1	56,054	221,010
Modifikime nga fitimi i mbajtur		4,090,104	(11,013,300)
<b>Fitimi operativ pas ndryshimeve në kapitalin punues</b>		<b>10,303,708</b>	<b>1,966,043</b>
<b>Tatimi në fitim i paguar</b>	<b>20</b>		
<b>Paraja neto e gjeneruar nga aktivitetet operative</b>		<b>10,303,708</b>	<b>1,966,043</b>
<b>AKTIVITETET INVESTUESE</b>			
Blerja e pronave dhe pajisjeve	4,5	(697,733)	(619,946)
Modifikimet në vlerën e fabrikës, pronave, paisjeve		46,759	3,033,751
Pasuritë e pranuar përmes granteve		(2,712,758)	-
<b>Paraja neto e përdorur në aktivitetet investuese</b>		<b>(3,363,732)</b>	<b>2,413,805</b>
<b>AKTIVITETET FINANCUERE</b>			
Kreditë e reja të pranuar	12	-	319,808
Pagesat e kreditës	12	(2,502,952)	(2,422,000)
Të hyrat e shtyera	13	(136,026)	(203,955)
Interesi i paguar		(2,493,782)	(2,440,470)
<b>Paraja neto e gjeneruar nga aktivitetet financuese</b>		<b>(5,132,760)</b>	<b>(4,746,617)</b>
<b>Neto rritja e parasë dhe ekuivalentëve të saj gjatë vitit</b>		<b>1,807,216</b>	<b>(366,769)</b>
<b>Paraja dhe ekuivalentët e parasë, në fillim të vitit</b>		<b>2,833,997</b>	<b>3,200,766</b>
<b>Paraja dhe ekuivalentët e parasë, në fund të vitit</b>	<b>8</b>	<b>4,641,214</b>	<b>2,833,997</b>

Pasqyra e rrjedhës së parasë duhet lexuar së bashku me shënimet e paraqitura nga faqet 5 deri 30, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

## SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

### 1. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

Zhvillimi ndër vite i Ujësjesit, është i lidhur ngushtë me historikun e zhvillimit në të gjitha fushat në Prishtinë, në cilësinë e kryeqytetit si dhe vendbanimeve (sidomos dy qendrave të mëdha tashmë administrative: Fushë Kosovë dhe Obiliq) që gravitojnë afër kryeqendrës. Pas luftës së Kosovës (1998-1999) kompania i është nënshtruar procesit të konsolidimit përkatësisht regjionalizimit. Tash zona e shërbimit është e shtrirë në gjithë territorin e Kosovës qëndrore.

Furnizimi me ujë i Prishtinës, daton që nga kohët e hershme nga burimet natyrale të Gërmisë kurse më vonë nga pusët në Kolovicë. Prishtina në vitin 1961 kishte përafërsisht 38,593 banorë. Në këtë vit fillon shfrytëzimi i liqenit akumulues të Badovcit për furnizimin e qytetit të Prishtinës dhe rrethinës me ujë të pijes.

Në fund të viteve '70 të shekullit të kaluar, paralelisht me rritjen dhe zhvillimet urbanistike në qytetin e Prishtinës dhe rrethinës fillon edhe rritja e kërkesave për ujë të pijes dhe largimin e ujërave të ndotura. Shtohen sasi të ujit të pijes duke shfrytëzuar akumulimin e liqenit të Batllavës, burimet nëntokësore në Fushë Kosovë dhe Obiliq. Përveç shtimit të sasisë së ujit në këtë periudhë janë bërë edhe investimet kualitative në rrjetin shpërndarës të ujit të pijes dhe ujërave të zeza.

Në vitin 2007 ndërmarrja shëndrohet në Ndërmarrje aksionare me emërtimin: Kompania Rajonale e Ujësjesit "Prishtina"-Ndërmarrje Aksionare, dhe është 100% në pronësi të Republikës së Kosovës.

Ndërmarrja ka të organizuar ofrimin e shërbimeve të ujit të pijes dhe barjten-largimin e ujërave të zeza në komunat: Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliq, Lipjan, Podujevë, Gllogoc dhe Graçanicë (pjesërisht edhe në komunën e Vushtrisë).

### 2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

#### 2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare të ndërmarrjes për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 janë përgatitur në përputhje me SNRF, siç janë publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

Pasqyrat financiare SNRF të Ndërmarrjes përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyra e ndryshimeve në ekuitet, pasqyra e rrjedhës së pasasë, politikat e rëndësishme kontabël dhe shënimet për pasqyrat financiare.

#### 2.2 Bazat e përgatitjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur nën parimin e kostos historikedukë përfshië Pronat, Impiantet dhe Pajisjet e bartuar në rastin e korporatizimit në vitin 2007 të cilat konsiderohen të jenë kosto në vitin e inkorporimit. Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Euro ("Euro"), e cila është monedha funksionale e Ndërmarrjesë.

#### 2.3 Parimi i vijimësisë

Menaxhmenti i Ndërmarrjes vlerëson se ekziston aftësia e ndërmarrjes për të vazhduar biznesin dhe operacionet e saj dhe është i kënaqur që ka burime të mjaftueshme për të vazhduar biznesin e saj për një të ardhme të parashikueshme. Për më tepër, menaxhmenti nuk është në dijeni të ndonjë pasigurie materiale që mund të hedhin dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e Ndërmarrjesë për të vazhduar aktivitetin. Prandaj, pasqyrat financiare vazhdojnë të jenë të përgatitura në bazë të parimit të vijimësisë.



## SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

### 2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

#### 2.4 Prona dhe pajisjet

##### i. Njohja dhe matja

Ndwmarrja zbaton modelin e kostos konform kwrkesave tw SNK 16. Zërat e pronës dhe pajisjeve më 1 janar 2007 janë paraqitur me koston e konsideuar të reduktuar për zhvlerësimin e akumuluar dhe dëmtimin, përfshirë edhe zërat e pronës, impianteve dhe pajisjeve më 1 janar 2007 të cilat paraqiten me koston e konsideruar të reduktuar për zhvlerësimin dhe dëmtimin. Kostoja përfshinë shpenzimet që janë drejtpërdrejtë të lidhura me blerjen e pasurisë. Kur pjesët e një zëri të pronës dhe pajisjeve kanë jetëgjatësi të përdorimit të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra (përbërësit kryesor) të pronës, impianteve dhe pajisjeve.

Tokat dhe servituetet mbahen sipas koston së vlerësuar dhe nuk zhvlerësohen. Zhvlerësimi për pasuritë tjera është llogaritur duke përdorur metodën drejtvizore sipas Rregullores për Regjistrimin, kontrollin dhe raportimin e mjeteve themelore në % si në vijim:

Emërtimi	Norma e zhvlerësimit (%)
A - Toka dhe servituetet:	0%
B - Ndërtesat dhe strukturat ndërtimore	2.5%
C - Rrjeta e ujësjellësit	2.5%
D - Rrjeta e kanalizimit,	2.5%
E – Kyçje në Ujësjellës,	2.5%
F – Ujëmatësit,	10%
G - Pajisjet elektrike dhe makinerike,	10%
H - Pajisjet e mirëmbajtës,	10%
I - Automjetet,	10%
J – Pajisjet e IT-se,	20%
K – Pajisjet e zyrave,	10%
L – Mobilet e zyrave.	10%
M – Pasuritë e Paprekshme	10%

Menaxhmenti i kompanisë gjatë vitit tw kaluar ka rishikuar politikën kontabël për pronat, impiantet dhe pajisjet dhe duke marrë në kosideratë të gjithë faktorët e e rëndësishëm me theks të vecantë paraqitjen sa më kualitative të pasqyrave financiare ka vendosur që të anulojë raportin e rivlerësimit të vitit 2019 dhë të bëjë paraqitjen mbi bazën e koston/koston së konsideruar.

##### ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të pronës dhe pajisjeve njihet në vlerën kontabël të zërit nëse është e mundur që përfitimet ekonomike në të ardhmen të trupëzuara përbrenda pasurisë do të rrjedhin në Ndërmarrje dhe kostoja e saj mund të matet me besueshmëri. Kostot e servisimit të pronës dhe pajisjeve njihen në pasqyrën e të ardhurave në momentin kur ndodhin.



## SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

### 2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

#### 2.4 Prona dhe pajisjet (vazhdim)

##### iii. Zhvlerësimi

Zhvlerësimi vjetor njihet në fitim ose humbje/ pasqyrën e të ardhurave në baza lineare përgjatë jetëgjatësisë të çdo pjese të një zëri të pajisjeve.

#### 2.5 Dëmtimi i pasurive jo-financiare

Ndërmarrja vlerëson në çdo datë raportimi nëse ka ndonjë tregues që një pasuri mund të jetë rënë në vlerë. Nëse ekziston ndonjë tregues i tillë, shuma e rikuperueshme e pasurisë vlerësohet të përcaktojë masën e humbjes së së dëmtimit (nëse ka) pasurive. Shuma e rikuperueshme e një pasurie është vlera më e lartë ose vlera e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare e drejtë minus kosto e shitjes dhe vlerës së tij në përdorim dhe të përcaktohet për një pasuri individuale, përveç rastit kur pasuria nuk gjeneron rrjedhje hyrës të parasë të cilat janë të pavarura nga të tjera pasuri ose grup pasurish.

Kur vlera kontabël e një pasurie tejkalon vlerën e rikuperueshme, pasuria është konsideruar e rënë në vlerë dhe është shlyer deri në shumën e rikuperueshme. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, rrjedhjet e ardhshme të parasë të vlerësuara janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregut të vlerës në kohë të parasë dhe risqet specifike për pasurinë. Në përcaktimin e vlerës së drejtë minus koston për të shitur, transaksionet e fundit të tregut merren parasysh, nëse është e mundur. Nëse transaksione të tilla nuk mund të identifikohen, përdoret një model i përshtatshëm vlerësimi.

Humbjet nga rënia në vlerë e operacioneve të vazhdueshme, njihen në pasqyrën e të ardhurave në ato kategori të shpenzimeve të cilat janë në përputhje me funksionin e pasurive të rëna në vlerë.

#### 2.6 Njohja fillestare dhe matja

Përveç të arkëtueshmeve tregtare të cilat nuk përmbajnë në vete përbërës të konsiderueshëm financimi dhe maten me cmimin e transaksionit në pajtueshmëri më SNRF 15, të gjitha pasuritë tjera financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë të korigjuar pëe koston e transaksionit (aty ku është e zbatueshme). Pasuritë financiare, me përjashtim të pasurive financiare të paracaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtëse, klasifikohen në këto kategori:

- Kosto të amortizuara
- Vlera e drejtë përmes fitimit ose humbje(FVTPL)
- Vlera e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse (FVOCI)

Në periudhat e paraqitura Ndërmarrja nuk ka asnjë pasuri financiare të kategorizuar si :FVOCI dhe FVTPL

#### Matja e mëpasshme

Për qëllime të matjes së mëpasshme , pasuritë financiare klasifikohen në katër kategori:

- Pasuritë financiare me koston e amortizuar (instrumentet e borxhit)
- Instrumentet e borxhit me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse (FVOCI), ku fitimet ose humbjet kthehen si mosnjohje në pasqyrën e fitimit ose humbjeve;



## SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

### 2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

#### 2.6 Njohja fillestare dhe matja (vazhdim)

Matja e mëpasshme (vazhdim)

- Instrumentet e kapitalit në FVOCI, pa kthimin e fitimeve ose humbjeve si mosnjohje në pasqyrën e fitimit ose humbjeve;
- Pasuritë financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes

#### 2.7 Instrumentet financiare

##### a) Pasuritë financiare

##### Pasuritë financiare me koston e amortizuar

Ndërmarrja mban pasuri financiare vetëm të kategorisë së parë, prandaj kjo kategori është e vetmja e rëndësishme për Ndërmarrjen. Ndërmarrja matë pasuritë financiare me koston e amortizuar nëse plotësohen të dyja kushtet e mëposhtme:

- Pasuria financiare mbahet brenda një model biznesi me qëllim të mbajtjes së pasurive financiare për mbledhjen e rrjedhave kontraktuale të parasë, dhe
- Kushtet kontraktuale të pasurisë financiare paraqiten në datat e përcaktuara në rrjedhjet e parasë të cilat janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën e principalit të papaguar.

Pasuritë financiare me koston e amortizuar maten më pas duke përdorur metodën e interesit efektiv (NEI) (nëse ka interes) dhe janë subjekt i rënies në vlerë. Fitimet dhe humbjet njihen në fitim ose humbje kur pasuria çregjistrohet, modifikohet ose ka rënë në vlerë.

Pasuritë financiare të Ndërmarrjes me koston e amortizuar përbëhen kryesisht nga të arkëtueshmet tregtare dhe paraja dhe ekuivalentët e parasë.

##### Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Përfshijnë balancat e parasë dhe depozitat afatshkurtra. Mbitërheqjet nga bankat që janë të ripagueshme sipas kërkesës (nëse ka) dhe formojnë një pjesë integrale të menaxhimit të parasë së Ndërmarrjes janë përfshirë si një përbërës i parasë dhe ekuivalentëve të parasë për qëllimin e pasqyrës së rrjedhës së parasë.

##### Mosnjohja

Një pasuri financiare (ose, kur është e zbatueshme një pjesë e pasurive financiare ose pjesë të një grupi pasurish financiarë të ngjashme) c' regjistrohet kur:

- Të drejtat për të marrë para nga pasuria kanë skaduar; ose;
- Ndërmarrja ka transferuar të drejtat e saj për të marrë para nga pasuria ose e ka marrë përsipër një detyrim për të paguar rrjedhje të parasë të marra në mënyrë të plotë, pa vonesë materiale për një palë të tretë sipas një marrëveshje 'përçimit'; ose (a) Ndërmarrja ka transferuar kryesisht të gjitha risqet dhe përfitimet e pasurisë, ose (b) Ndërmarrja as nuk ka transferuar as nuk ka ruajtur kryesisht të gjitha risqet dhe përfitimet e pasurisë, por ka transferuar kontrollin e pasurisë.

##### Rënia në vlerë e pasurive financiare

Ndërmarrja përdor një qasje të thjeshtuar në kontabilizimin e të arkëtueshmeve tregtare dhe të tjera dhe regjistron kompenzimin për humbje si humbjet e pritshme të kreditit të jetës. Këto janë mangësitë e pritura në flukset e mjeteve monetare kontraktuale, duke pasur



## SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

### 2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

#### 2.7 Instrumentet financiare (vazhdim)

##### a) Pasuritë financiare (vazhdim)

###### *Rënia në vlerë e pasurive financiare (vazhdim)*

Marrw parasysh potencialin e mosplotësimit në cdo moment gjatë jetës së instrumentit financiar. Gjatë llogaritjes, kompania përdor përvojën e saj historike, treguesit e jashtëm dhe informacionin e ardhëshëm për të llogaritur humbjet e pritshme të kredisë duke përdorur matricë provizioni.

Në çdo datë të bilancit të gjendjes, Ndërmarrja rishikon vlerën kontabël të pasurive të saj financiare, në mënyrë që të përcaktojë nëse ka ndonjë tregues që ato pasuri kanë pësuar humbje nga rënia në vlerë. Vlerësimi i humbjeve të pritshme nga rënia në vlerë kryhet në baza individuale për të gjitha të arkëtueshmet, pasi që shumën e të arkëtueshmeve tregtare është nga Kompania mëmë.

Ndërmarrja njih një lejim (provizion) për humbjet e pritura kreditore (ECL) për të gjithë instrumentet e borxhit që nuk mbahen me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes, kur identifikohet rënia në vlerë. ECL bazohen në diferencën midis rrjedhave kontraktuale të parave të gatshme në përputhje me kontratën dhe të gjitha rrjedhave të parave që Ndërmarrja pret të marrë, zbritur në një përafrim të normës efektive origjinale të interesit. Rrjedhat e parave të pritshme do të përfshijnë rrjedha monetare nga shitja e kolateralit të mbajtur ose përmirësime të tjera kreditore që janë pjesë përbërëse e kushteve kontraktuale, nëse ka ndonjë.

##### b) Detyrimet financiare

###### *Njohja fillestare dhe matja*

Detyrimet financiare janë klasifikuar si detyrime financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kredive dhe huave, apo si derivate të përcaktuara si instrumente mbrojtëse në një mbrojtje efektive, sipas rastit. Ndërmarrja përcakton klasifikimin e detyrimeve të saj financiare në njohjen fillestare. Të gjitha detyrimet financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë, në rastin e kredive dhe huave, neto të kostove të transaksionit që i atribuohen drejtpërdrejtë.

Detyrimet financiare të Ndërmarrjes përfshijnë të pagueshmet tregtare dhe tjera.

###### **Matja e mëpasshme**

Matja e detyrimeve financiare varet nga klasifikimi i tyre si më poshtë:

###### *Detyrimet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes*

Detyrimet financiare me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes përfshijnë detyrimet financiare të mbajtura për tregtimin dhe detyrimet financiare të përcaktuara me njohjen fillestare, me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes. Ndërmarrja nuk ka caktuar ndonjë detyrim financiar pas njohjes fillestare, me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes.

###### *Kreditë dhe huazimet*

Pas njohjes fillestare, kreditë dhe huazimet me interes maten më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën efektive të normës së interesit. Fitimet dhe humbjet njihen në pasqyrën e të ardhurave kur detyrimet çregjistrohen, si dhe përmes procesit të amortizimit efektiv të normës së interesit (EIR). Kostoja e amortizuar llogaritet duke marrë parasysh çdo zbritje ose primin e blerjes dhe tarifën ose koston që janë pjesë përbërëse e EIR. Amortizimi i EIR përfshihet në shpenzimet financiare në pasqyrën e të ardhurave.



## SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

### 2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

#### 2.7 *Instrumentet financiare (vazhdim)*

##### (b) *Detyrimet financiare (vazhdim)*

##### **Matja e mëpasshme (vazhdim)**

##### *Mosnjohja/ C'regjistrimi*

Një detyrim financiar çregjistrohet kur obligimi nga detyrimi shkarkohet ose anulohet ose skadon. Kur një detyrim financiar ekzistues zëvendësohet nga një tjetër nga i njëjti huadhënës me kushte thelbësisht të ndryshme, ose kushtet e një detyrimi ekzistues janë modifikuar në mënyrë thelbësore, një shkëmbim ose modifikim i tillë trajtohet si mosnjohje e detyrimit fillestar dhe njohje e një detyrimi të ri, dhe diferenca në vlerat kontabël përkatëse njihet në pasqyrën e të ardhurave.

##### *Të pagueshmet tregtare dhe tjera*

Detyrimet për tregti dhe shumat e tjera të pagueshme maten me kosto e cila është vlera e drejtë e shumës që do të paguhet në të ardhmen për mallrat dhe shërbimet e marra pavarësisht nëse i faturohen Ndërmarrjesë apo jo.

##### *Huamarrjet*

Huamarrjet përfshijnë hua të marra nga aksionarët. Huamarrjet njihen fillimisht me vlerën e drejtë minus kostot e atribueshme të transaksionit. Pas njohjes fillestare, huamarrjet deklarohen me kosto të amortizuar me çdo ndryshim midis shumës në njohjen fillestare dhe vlerës së shlyerjes që njihet në fitim ose humbje gjatë periudhës së huamarrjeve mbi një bazë efektive interesi.

##### *Netimi i instrumenteve financiare*

Pasuritë dhe detyrimet financiare janë netuar dhe shuma neto e raportuar në pasqyrën e pozicionit financiar nëse ekziston një e drejtë ligjore aktualisht e zbatueshme për të netuar shumat e njohura dhe ka një qëllim që të shlyhen në bazë neto, ose të realizojnë pasuritë dhe shlyerjen e detyrimeve njëkohësisht.

#### 2.8 *Tatimi në të ardhura*

Tatimi parashikohet në pasqyrat financiare në përputhje me rregulloren tatimore të Kosovës e cila aktualisht është në fuqi, Ligji nr. 06/L-105 "Mbi Tatimin në të Ardhurat e Korporatave".

Tatimi mbi të ardhurat i ngarkuar në fitim ose humbje për vitin përfshin tatimin aktual dhe ndryshimet në tatimin e shtyrë. Tatimi aktual është llogaritur në bazë të fitimit të tatueshëm që pritet për vitin duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e bilancit. Fitimi i tatueshëm ndryshon nga fitimi i raportuar në fitim ose humbje, sepse ai përjashton zërat e të ardhurave ose shpenzimeve që janë të tatueshme ose të zbritshme në vitet tjera dhe atë më tej përjashton zërat që nuk janë të tatueshme ose të zbritshme. Tatime të tjera përveç tatimit në të ardhura janë regjistruar në kuadër të shpenzimeve operative.

Tatimi i shtyrë njihet për diferencat midis vlerës kontabël të pasurive dhe detyrimeve në pasqyrat financiare dhe bazës së taksave korresponduese të përdorura në llogaritjen e fitimit të tatueshëm dhe kontabilizohen duke përdorur metodën e detyrimeve të bilancit. Ndërmarrja nuk ka detyrime të shtyra të tatimit për vitin 2021.



## SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

### 2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

#### 2.9 *Stoqet*

Stoqet mbahen në vlerë më të ulët të kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kostoja përfshinë koston direkte lidhur me stoqet dhe ato indirekte që janë shkaktuar për sjelljen e stoqeve në vendndodhjen dhe kushtet e tyre aktuale. Kostoja e stoqeve përfshinë: koston e blerjes së mallit, koston e transportit, detyrimet doganore, akcizën etj.

Vlera neto e realizueshme (VNR) paraqet çmimin e vlerësuar të shitjes për stoqet minus koston e vlerësuar të kompletimit dhe shpenzimeve të nevojshme për të bërë shitjen.

Menaxhmenti i Ndërmarrjesë gjatë vitit monitoron në mënyre periodike çmimet e shitjes me koston e stoqeve dhe në qoftë se çmimi është ulur nën kosto, diferenca njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse si rënie në vlerë e stoqeve.

Kostoja e stoqeve është e bazuar në metodën mesatare të koston. Kompensimi i përshtatshëm për rëniet në vlerë njihet në fitim dhe humbje kur ka evidencë objektive që VNR është më e ulët se kostoja.

#### 2.10 *Paraja dhe ekuivalentët e parasë*

Paraja dhe ekuivalentët e parasë përfshijnë paratë në dorë dhe paratë e pakufizuara të mbajtura nga banka ose depozita me afat maturimi më pak se tre muaj.

#### 2.11 *Njohja e të ardhurave*

Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose të arkëtueshme dhe përfaqëson shumën e arkëtueshme për mallërat dhe shërbimet e ofruara në rrjedhën normale të biznesit, duke zbritur zbritur zbritjet dhe taksat e lidhura me shitjet.

Të ardhurat njihen kur kontrolli i mallrave ose shërbimeve transferohet tek klienti në një shumë që reflekton kompensimin që Ndërmarrja pret të ketë të drejtë në këmbim të transferimit të këtyre mallrave ose shërbimeve për një klient (në përputhje me SNRF 15).

Ndërmarrja njih detyrimet e kontratës për shumën e marrë në lidhje me kushtet e performancës së pakënaqur dhe raporton këto si detyrime të tjera në pasqyrën e pozicionit financiar. Në mënyrë të ngjashme, nëse Ndërmarrja përmmbushë një kusht të performancës para se të marrë shumën, ndërmarrja njih ose një pasuri të kontratës ose një të arkëtueshme në pasqyrën saj të pozicionit financiar, në varësi të faktit nëse kërkohet diçka tjetër përveç kohës së kalimit para se të bëhet pagesa.

#### 2.12 *Transaksionet me valuta të huaja*

Transaksionet në valuta të tjera nga valuta funksionale (valuta të huaja) janë të regjistruara me kursin e këmbimit që mbizotëron në datën e transaksioneve. Në çdo datë bilanci, zërat monetarë të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin që mbizotëron në datën e bilancit. Zërat jomonetarë që maten në termat e koston historike në monedhë të huaj nuk rivlerësohen. Diferencat e këmbimit që vijnë nga shlyerja e zërave monetarë, dhe mbi kthimet e zërave monetarë, janë të përfshira në fitimin dhe humbjen e periudhës.



## SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

### 2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

#### 2.13 Përfitimet e punonjësve

Ndërmarrjanë rrjedhën normale të biznesit, kryen pagesa në emër të vet dhe në emër të punonjësve të saj për të kontribuar për pensionin e detyrueshëm sipas legjislacionit lokal. Shpenzimet e bëra në emër të Ndërmarrjesë janë ngarkuar në pasqyrën e të ardhurave në momentin kur ndodhin .

#### 2.14 Zotimet dhe kontingjencat

Detyrimet kontingjente nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato nuk shpalosen vetëm nëse mundësia e rrjedhës së parasë që trupëzon përfitimet ekonomike është e largët. Një pasuri kontingjente nuk njihet në pasqyrat financiare por shpaloset kur rrjedhja e përfitimeve ekonomike është e mundshme.

Shuma e humbjes kontingjente njihet si provizion nëse Ndërmarrja ka një detyrim aktual (ligjor ose konstruktiv) si rezultat i një ngjarje të kaluar, është e mundshme që një dalje e burimeve të trupëzuara në përfitimet ekonomike do të kërkohet për të shlyer detyrimin; dhe mund të bëhet një vlerësim i besueshëm i shumës së detyrimit.

#### 2.15 Gjykimet kritike në aplikimin e politikave kontabël të njësisë ekonomike

Në procesin e zbatimit të politikave të kontabël të Ndërmarrjesë, të cilat janë të përshkruara më sipër, menaxhmenti nuk ka bërë gjykime që mund të kenë efekte të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare në këtë vit financiar.

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që menaxhmenti të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të pasurive dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve dhe shpalosjet e detyrimeve kontingjente në fund të periudhës raportuese. Pasiguria rreth këtyre supozimeve dhe vlerësimeve mund të rezultojë në rezultate që kërkojnë një rregullim material të vlerës kontabël të pasurisë ose detyrimit të ndikuar në periudhat e ardhshme.

Supozimet kryesore lidhur me të ardhmen dhe burime të tjera kryesore të pasigurisë në vlerësim në datën e raportimit, që kanë një risk të rëndësishëm në shkaktimin e një rregullimi material në vlerat kontabël të pasurive dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar janë diskutuar më poshtë. Ndërmarrja bazon supozimet dhe vlerësimet e saj në parametrat në dispozicion, kur janë përgatitur pasqyrat financiare. Rrethanat dhe supozimet ekzistuese në lidhje me zhvillimet e ardhshme, megjithatë, mund të ndryshojnë për shkak të ndryshimeve të tregut ose rrethanave që dalin jashtë kontrollit të Ndërmarrjesë. Këto ndryshime pasqyrohen në supozimet kur ato ndodhin.

- (i) shënimi 7 – stoqet
- (ii) shënimi 19 – tatimi në fitim

#### 2.16 Qiratë

Në fillimin e një kontrate, Ndërmarrja vlerëson nëse një kontratë është, ose përmban, një qira. Kjo do të thotë nëse kontrata përcjell të drejtën për të kontrolluar përdorimin e një pasurie të identifikuar për një periudhë kohe në këmbim të pagesës.

#### Ndërmarrja si qiramarrëse

Ndërmarrja zbaton një qasje të vetme njohjeje dhe matjeje për të gjitha qiratë, përveç qirave afatshkurtra dhe qirave të pasurive me vlerë të ulët. Ndërmarrja njihet detyrimet e qirasë për të bërë pagesa qiraje dhe të drejtën e përdorimit se pasurive që përfaqësojnë të drejtën e përdorimit të pasurive themelore.



## SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

### 2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

#### 2.16 Qiratë (vazhdim)

Ndërmarrja si qiramarrëse (vazhdim)

##### i) E drejta e përdorimit të pasurive

Ndërmarrja njih të drejtën e përdorimit të pasurive në datën e fillimit të qirasë (d.m.th., data kur pasuria në fjalë është në dispozicion për përdorim).

E drejta e përdorimit të pasurive matet sipas koston, minus çdo zhvlerësim të akumuluar dhe humbje nga rënia në vlerë, dhe rregullohen për çdo ri-matje të detyrimeve të qirasë. E drejta e përdorimit të pasurive përfshin shumën e njohur të detyrimeve të qirasë, kostot fillestare direkte të bëra dhe pagesat e qirasë të bëra në ose para datës së fillimit minus çdo stimul i marrë nga qiraja. E drejta e përdorimit të pasurive zhvlerësohet mbi një bazë lineare përgjatë afatit më të shkurtër të qirasë dhe jetëgjatësisë së vlerësuar të pasurive, si më poshtë:

##### ii) Detyrimet e Qirasë

Në datën e fillimit të qirasë, Ndërmarrja njih detyrimet e qirasë të matura me vlerën aktuale të pagesave të qirasë që duhen bërë gjatë afatit të qirasë. Pagesat e qirasë përfshijnë pagesa fikse (përfshirë pagesat fikse në thelb) minus çdo stimul të qirasë të arkëtueshme, pagesa variabile të qirasë që varen nga një indeks ose një normë dhe shumat që pritet të paguhen nën garancitë e vlerës së mbetur. Pagesat e qirasë gjithashtu përfshijnë çmimin e ushtrimit të një opsioni blerjeje të arsyeshëm që do të ushtrohet nga Ndërmarrja dhe pagesa të gjobave për përfundimin e qirasë, nëse afati i qirasë pasqyron Grupin që ushtron opsionin e përfundimit.

Pagesat e ndryshueshme të qirasë që nuk varen nga një indeks ose një normë, njihen si shpenzime (nëse nuk janë bërë për të prodhuar stoqe) në periudhën në të cilën ndodh ngjarja ose kushti që shkakton pagesën.

Detyrimi i qirasë fillimisht matet me vlerën aktuale të pagesave të qirasë që nuk janë paguar në datën e fillimit, të zbritura duke përdorur normën e interesit të nënkuptuar në qira ose, nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet lehtësisht, norma rritëse e huamarjes së Ndërmarrjesë.

Pas datës së fillimit, shuma e detyrimeve të qirasë rritet për të reflektuar mbledhjen e interesit dhe zvogëlohet për pagesat e qirasë të bëra. Për më tepër, vlera kontabël e detyrimeve të qirasë ri-matet nëse ka një modifikim, një ndryshim në afatin e qirasë, një ndryshim në pagesat e qirasë (p.sh., ndryshimet në pagesat e ardhshme që rezultojnë nga një ndryshim në një indeks ose normë të përdorur për të përcaktuar të tilla pagesa të qirasë) ose një ndryshim në vlerësimin e një opsioni për të blerë pasurinë në fjalë.



## SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

### 2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

#### 2.17 Adoptimi i standardeve të reja ose të rishikuara dhe interpretimi i tyre

##### 2.17.1 Zbatimi fillestar i ndryshimeve të reja të standardeve ekzistuese efektive për periudhën aktuale të raportimit

###### i) Standardet dhe Interpretimet në fuqi në periudhën aktuale

Ndryshimet e mëposhtme të standardeve ekzistuese të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) janë efektive për periudhën aktuale të raportimit:

- **Reforma e Referencës së Normës së Interesit - Faza 2 - SNRF 9, SNK 39, SNRF 7, SNRF 4 dhe SNRF 16 (Ndryshime)** - Në gusht 2020, BSNK publikoi Reformën e Referencës së Normës së Interesit - Faza 2, Ndryshimet në SNRF 9, SNK 39, SNRF 7, SNRF 4 dhe SNRF 16, duke përfunduar punën e tij në përgjigje të reformës IBOR. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2021 me aplikim të mëhershëm të lejuar. Subjekti nuk ka asnjë pasuri ose detyrim financiar me normë fleksibël dhe nuk do të ketë ndonjë ndikim nga miratimi i këtij amendamenti.
- **Koncesione Qiraje të Lidhura me Covid-19 përtej 30 qershorit 2021 – Ndryshime në SNRF 16** - Në mars 2021, Bordi ndryshoi kushtet e dobisë praktike në SNRF 16 që ofron lehtësim për qiramarrësit nga zbatimi i udhëzimit të SNRF 16 mbi modifikimet e qirasë për koncesionet e qirasë që lindin si pasojë e drejtpërdrejtë e pandemisë Covid-19. Subjekti nuk ka negociuar asnjë koncesion qiraje lidhur me Covid-in me qiradhënësit e tij dhe nuk ka asnjë ndikim nga ky ndryshim.

Miratimi i këtyre ndryshimeve në standardet dhe interpretimet ekzistuese nuk ka çuar në ndonjë ndryshim material në pasqyrat financiare të Ndërmarrjesë pasi ajo nuk ka marrë asnjë koncesion qiraje.

###### ii) Standardet dhe ndryshimet në standardet ekzistuese akoma jo-efektive

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardi i ri i mëposhtëm dhe ndryshimet në standardet ekzistuese ishin në nxjerrje, por jo ende në fuqi:

- **Ndryshimet në SNRF 10 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara" dhe SNK 28 "Investime në Pjesëmarrje dhe Sipëmarrje të Përbashkëta" – Shitja ose kontributi i aseteve ndërmjet një investitori dhe bashkëpunëtorit të tij apo sipërmarrjes së përbashkët** – Ndryshimet adresojnë një mospërputhje të pranuar midis kërkesave të SNRF 10 dhe atyre në SNK 28, në trajtimin e shitjes ose kontributit të aseteve ndërmjet një investitori dhe Ndërmarrjesë ose sipërmarrjes së përbashkët.
- **SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare: Klasifikimi i detyrimeve si Qarkulluese ose Jo-Qarkulluese (Ndryshimet)** - Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022 me leje për aplikim të mëparshëm. Sidoqoftë, në përgjigje të pandemisë Covid-19, Bordi e ka shtyrë datën efektive me një vit, d.m.th. 1 janar 2023, për t'u dhënë Ndërmarrjeve më shumë kohë për të zbatuar çdo ndryshim klasifikimi që rezulton nga ndryshimet



## SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

### 2 PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

#### 2.17 Adoptimi i standardeve të reja ose të rishikuara dhe interpretimi i tyre (vazhdim)

##### 2.17.1 Zbatimi fillestar i ndryshimeve të reja të standardeve ekzistuese efektive për periudhën aktuale të raportimit (vazhdim)

#### ii) Standardet dhe ndryshimet në standardet ekzistuese akoma jo-efektive (vazhdim)

- **SNRF 3 Kombinimet e Biznesit; SNK 16 Pronat, impiantet dhe pajisjet; SNK 37 Provizionet, Detyrimet e Kushtëzuara dhe Pasuritë Kontingjente si dhe Përmirësimet Vjetore 2018-2020 (Ndryshimet)** - Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022 me leje për aplikim më të hershëm. BSNK ka nxjerrë ndryshime me shtrirje të ngushtë në Standardet SNRF si më poshtë:
  - **SNRF 3 Kombinimet e Biznesit (Ndryshimet)**
  - **SNK 16 Pasuritë afatgjata materiale (Ndryshimet)**
  - **SNK 37 Provizionet, Detyrimet Kontingjente dhe Pasuritë Kontingjente (Ndryshimet)**
- **SNK 8 Politikat e Kontabilitetit, Ndryshimet në Vlerësimet e Kontabilitetit dhe Gabimet: Përkufizimi i Vlerësimeve Kontabël (Ndryshimet)** - Ndryshimet hyjnë në fuqi për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2023 me aplikim më të hershëm të lejuar dhe zbatohen për ndryshimet në politikat kontabël dhe ndryshimet në vlerësimet kontabël që ndodhin në ose pas fillimit të asaj periudhe. Ndryshimet prezantojnë një përkufizim të ri të vlerësimeve kontabël, të përcaktuara si shuma monetare në pasqyrat financiare që janë subjekt i pasigurisë në matje.
- **SNK 12 Tatimet mbi të ardhurat: Tatimi i shtyrë në lidhje me pasuritë dhe detyrimet që rrjedhin nga një transaksion i vetëm (Amendimet)** - Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2023 me aplikim të mëhershëm të lejuar. Në maj 2021, Bordi nxori ndryshime në SNK 12, të cilat ngushtojnë objektin e përjashtimit të njohjes fillestare sipas SNK 12 dhe specifikojnë se si kompanitë duhet të llogarisin për tatimin e shtyrë për transaksione të tilla si qiratë dhe detyrimet e çaktivizimit.

Ndërmarrja ka zgjedhur që të mos miratojë këto standarde, rishikime dhe interpretime para datave të tyre efektive. Ndërmarrja parashikon që miratimi i këtyre standardeve, rishikimet dhe interpretimet nuk do të kenë ndikim material në pasqyrat financiare të Ndërmarrjes në periudhën e aplikimit fillestar.

## SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

### 3. NDRYSHIMET NË VLERËSIMET KONTABËL DHE GABIMET

Ndërmarrja ka një numër të konsiderueshëm të pasurive që janë plotësisht të zhvlerësuar, por ende në përdorim, gjë që tregon se pritet një jetë më e gjatë e dobishme. Prandaj, jetëgjatësia e mbetur e pasurive të zhvlerësueshme është rishikuar siç përshkruhet më poshtë në vitin paraprak

Ndërmarrja ka rishikuar gjithashtu kategoritë e pasurive në mënyrë që të ketë pasuri më të njëjta brenda secilës kategori dhe të unifikojë normat e zhvlerësimit, metodat e zhvlerësimit në përputhje me SNK 16 Prona, impiantet dhe pajisjet, dhe SNK 38 Pasuritë e Paprekshme në lidhje me përkufizimin e zhvlerësimit dhe jetëgjatësisë.

Rrjeti i bazuar në përvojën operacionale, vëzhgimin fizik dhe numërimin e pasurive fikse rishikoi metodën e zhvlerësimit të aplikuar për të gjitha llojet e pasurive që kishin një ndryshim të rëndësishëm në marrjen e pritshme të përfitimeve të ardhshme ekonomike që janë pjesë e pasurisë.

Kërkesat e standardeve të kontabilitetit

Sipas SNK 16 Prona, Impiantet dhe Pajisjet, metoda e zhvlerësimit e aplikuar në një pasuri do të rishikohet të paktën në çdo fund të vitit financiar dhe nëse ka pasur një ndryshim të rëndësishëm në marrjen e pritshme të përfitimeve të ardhshme ekonomike që janë pjesë e pasurisë, metoda do të të ndryshohet për të pasqyruar modelin e ndryshuar. Një ndryshim i tillë do të kontabilizohet si një ndryshim në vlerësimin kontabël në përputhje me SNK 8 Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet, me efekt të mundshëm.

Normat e zhvlerësimit, bazuar në jetëgjatësinë e vlerësuar janë si më poshtë dhe janë aplikuar që nga vitit 2019 kalkuluar duke filluar nga vitit 2019 efekti i viteve deri në vitin 2021 është bartur në këtë vit në mënyrë që pasqyrimi/ krahasueshmëria të jetë konform standardeve:

Emërtimi	Norma e zhvlerësimit (%)
A- Toka dhe servitutet:	0%
B- Ndërtesat dhe strukturat ndërtimore	2.5%
C- Rrjeta e ujësjellësit	2.5%
D- Rrjeta e kanalizimit,	2.5%
E- Kycje në Ujësjellës,	2.5%
F- Ujëmatësit,	10%
G- Pajisjet elektrike dhe makinerike,	10%
H- Pajisjet e mirëmbajtës,	10%
I- Automjetet,	10%
J- Pajisjet e IT-se,	20%
K- Pajisjet e zyrave,	10%
L- Mobilet e zyrave.	10%
M- Pasuritë e Paprekshme	10



## SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

### 4. PRONA DHE PAISJET

Kostot/Kostot e konsideruara:

	Toka	Ndërtesa	Paisje	Mobilje	Vetura	Pasuritë në ndërtim e sipër	Gjithsej
Më 1 janar 2022	19,569,363	100,036,176	25,166,360	242,321	1,715,934	770,879	147,501,034
Shtesat gjatë vitit	390	21,622	474,194	106	-	123,634	619,946
Korrigjimet gjatë vitit	(360)	(902,819)	(2,358,677)	56,419	(109,347)	-	(3,314,784)
<b>Më 31 dhjetor 2022_RISHIKUAR</b>	<b>19,569,393</b>	<b>99,154,979</b>	<b>23,281,877</b>	<b>298,846</b>	<b>1,606,586</b>	<b>894,514</b>	<b>144,806,195</b>
Shtesat gjatë vitit	13,467	489,163	474,355	11,703	-	3,283,829	4,272,518
Shlyerjet gjatë vitit	-	(24,438)	(276,374)	(7,045)	(6,350)	(862,027)	(1,176,234)
<b>Më 31 dhjetor 2023</b>	<b>19,582,860</b>	<b>99,619,704</b>	<b>23,479,859</b>	<b>303,504</b>	<b>1,600,236</b>	<b>3,316,316</b>	<b>147,902,480</b>

Zhvlertësimi i akumuluar:

Më 1 janar 2022	-	(39,220,853)	(15,846,691)	(141,827)	(1,175,704)	-	(56,385,076)
Shpenzimi për vitin	-	(359,988)	2,873,022	117,725	167,801	-	2,798,560
Rregullime tek zhvlertësimi paraprak	-	2,306,896	(7,240,107)	(231,100)	(329,401)	-	(5,493,712)
<b>Më 31 dhjetor 2022_RISHIKUAR</b>	<b>-</b>	<b>(37,273,946)</b>	<b>(20,213,775)</b>	<b>(255,202)</b>	<b>(1,337,305)</b>	<b>-</b>	<b>(59,080,228)</b>
Shpenzimi për vitin	-	(1,855,612)	(1,147,127)	(9,747)	(53,086)	-	(3,065,572)
Rregullime tek zhvlertësimi paraprak	-	7,629	238,826	6,290	2,543	-	255,287
<b>Më 31 dhjetor 2023</b>	<b>-</b>	<b>(39,121,929)</b>	<b>(21,122,077)</b>	<b>(258,659)</b>	<b>(1,387,848)</b>	<b>-</b>	<b>(61,890,513)</b>

Vlera neto:

Më 31 dhjetor 2022_RISHIKUAR	19,569,393	61,881,033	3,068,102	43,643	269,282	894,514	85,725,967
Më 31 dhjetor 2023	19,582,860	60,497,775	2,357,783	44,845	212,388	3,316,316	86,011,967

## SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

### 4. PRONA DHE PAISJET (VAZHDIM)

#### 4.1 Prona, impiantet dhe pajisjet e zhvlerësuara plotësisht

Më poshtë janë zërat e Pronës dhe Pajisjeve që janë zhvlerësuar plotësisht, por ende janë në përdorim më 31 dhjetor 2023:

Kategoria	31 dhjetor 2023 Kostot/ Kostot e konsideruara	31 dhjetor 2022 Kostot/ Kostot e konsideruara
Ndërtesat dhe strukturat ndërtimore	543	535
Rrjeta e Ujësjellësit	-	-
Ujëmatësit	3,887,347	3,887,317
Pajisjet elektrike dhe makinerikë	6,949,591	6,805,252
Pajisjet e Mirëmbajtjes	201,975	209,627
Automjetet	779,311	779,312
Pajisjet e IT-së	699,430	696,163
Pajisjet e zyrës	146,655	156,254
Mobilet e zyrës	153,935	154,902
Pasuritë e paprekshme	44,170	45,290
<b>Gjithsej</b>	<b>12,862,959</b>	<b>12,734,650</b>

### 5. PASURITË E PAPERKSHME

	Gjithsej
<b>Kostot/Kostot e konsideruara:</b>	
Më 1 janar 2022	650,676
Shtesat gjatë vitit	-
Korrigjime gjatë vitit	177,626
Më 31 dhjetor 2022 <b>_RISHIKUAR</b>	828,302
Korrigjime gjatë vitit	-
Më 31 dhjetor 2023	828,302
<b>Zhvlerësimi i akumuluar:</b>	
Më 1 janar 2022	(266,929)
Amortizimi për vitin	(329,046)
Më 31 dhjetor 2022	(595,974)
Amortizimi për vitin	(50,323)
Korrigjime gjatë vitit	12,160
Më 31 dhjetor 2023	(634,139)
<b>Vlera neto:</b>	
Më 31 dhjetor 2022	232,327
Më 31 dhjetor 2023	194,163



## SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

### 6. STOQET

Stoqet në pasqyrën e pozicionit financiar janë analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022 RISHIKUAR
Stoqet në depo	1,506,405	1,503,100
<b>Gjithsej</b>	<b>1,506,405</b>	<b>1,503,100</b>

### 7. TË ARKËTUESHMET TREGTARE DHE TË TJERA

Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera në pasqyrën e pozicionit financiar janë analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022 RISHIKUAR
Të arkëtueshme nga shërbimet bazë	52,229,331	52,993,866
Të arkëtueshme nga shërbime tjera	325,600	281,802
Borxhet e falura sipas ligjit	0	0
Të arkëtueshme tjera	551,546	551,958
Provizioni për të arkëtueshmet nga shërbimet bazë	(48,429,492)	(48,559,046)
Provizioni për të arkëtueshmet nga shërbimet tjera	(225,048)	(139,510)
Parapagimet	239,553	158,639
<b>Gjithsej</b>	<b>4,691,490</b>	<b>5,287,707</b>

### 8. PARAJA NË BANKA DHE NË ARKA

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022 RISHIKUAR
Paraja në banka	4,634,204	2,804,294
Paraja në arka	7,009	29,703
<b>Gjithsej</b>	<b>4,641,214</b>	<b>2,833,997</b>

Paratë mbahen në bankat komerciale, llogaritë rrjedhëse dhe risku i pritshëm kreditor nuk është i rëndësishëm.

## SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

### 9. KAPITALI AKSIONAR

Struktura e kapitalit aksionar të Ndërmarrjes është si vijon:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022 RISHIKUAR
Kapitali bazë	25,000	25,000
Fitimet e mbajtura	(16,558,712)	(22,224,582)
Fitimi i vitit	1,989,668	1,575,767
Rezerva për korporatizim dhe të tjera	72,826,472	72,813,005
<b>Gjithsej</b>	<b>58,282,429</b>	<b>52,189,190</b>

Ndërmarrja gjatë vitit 2023 kishtë trajtuar gjetjet nga Raporti i Auditimit të ZKA-së, ka bërë regjistrimet e nevojshme për korrigjime përmes Fitimit të Mbajtur lidhur me gjetjen A1 në vlerë prej 2.7 mln €, poashtu edhe tepricën e të hyrave të shtyera sipas gjetjes B1 në vlerë prej 4.3 mln. Si dhe i kishtë trajtuar dhe korrigjuar konform dokumenteve edhe Investimet në Vijim në vlerë prej 0.3mln€ sipas Gjetjes B2.

### 10. TË PAGUESHMET TREGTARE DHE TË TJERA

Llogaritë e pagueshme tregtare janë detyrime pa interes bartëse ndaj furnizuesve vendorë dhe të huaj

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022 RISHIKUAR
Të pagueshmet për furnitorë	1,189,666	860,767
Detyrimet tjera	2,936,574	2,942,427
<b>Gjithsej</b>	<b>4,126,240</b>	<b>3,803,193</b>

Tabela më poshtë i shpalosë më hollësisht detyrimet e tjera

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022 RISHIKUAR
<b>Detyrimet tjera janë si më poshtë:</b>		
Detyrimet ndaj punëtorëve	523,283	522,267
Të pagueshmet për garancione bankare	309	-
Detyrimet ndaj konsulencës	-	182,870
Avanset nga konsumatorët	406,409	396,226
Avanset nga pagesat e paidentifikuara të konsumatoreve	663,740	664,904
Detyrimet për tatimin në fitim	23,565	92,816
Detyrimet ndaj tatimeve të shtyera	1,319,267	1,083,343
<b>Gjithsej</b>	<b>2,936,574</b>	<b>2,942,427</b>



## SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

### 11.1 PROVIZIONET PËR RASTET E KONTESTEVE GJYQËSORE

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022 RISHIKUAR
Provizionet për rastet e kontesteve	277,064	221,010
<b>Gjithsej</b>	<b>277,064</b>	<b>221,010</b>

Duke marrë parasysh që kompania ballafaqohet më konteste gjyqësore, në këtë vit është kërkuar nga personat përgjegjës lista me rastet e kontesteve gjyqësore, dhe konform kërkeses së SNK 37, janë kontabilizuar provizione për të gjitha ato raste për të cilat është konsideruar se kemi rrezik të daljes së parasë në periudhat vijuese.

### 12. HUAMARRJET

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022 RISHIKUAR
<i>Pjesa afatshkurtër</i>		
Kreditë afatshkurtëra- KFW	1,350,867	2,460,867
Kreditë e pranuar - EBRD	159,856	79,808
<i>Pjesa afatgjatë</i>		
Kreditë e pranuar - KFW	5,100,000	6,413,000
Kreditë e pranuar - EBRD	80,000	240,000
<b>Gjithsej</b>	<b>6,690,723</b>	<b>9,193,675</b>

### 13. TË HYRAT E SHTYERA

	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022 RISHIKUAR
Të hyrat e shtyera	27,668,782	30,176,031
<b>Gjithsej</b>	<b>27,668,782</b>	<b>30,176,031</b>

Përveq projekteve që janë, Ndërmarrja ka filluar implementimin e projektit për Trajtimin e Ujërvë të Zeza. Aktualisht është e nënshkruara Marrëveshja për Kredi në mes të Ministrisë së Financave dhe Thesarit Francez për komponentin e Impiantit në vlerë prej 66 milion €, nga kjo shumë deri më tash janë realizuar procedurat e prokurimit dhe ka filluar ekzekutimit e shërbimeve për pjesën “Shërbimet Konsulente”, e cila kontratë në total kap vlerën afro 3.5 milion €.

## SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

Përveq kredisë sipërpërmendur, lidhur me Komponentin e Rrjetit të këtij projekti deri më tani janë nënshkruar marrëveshjes për fonde grant nga KfW, në total me vlerë prej 42 milion€.

Përveq projekteve të mësipërme, gjatë vitit 2023 Ndërmarrja ka nënshkruar Marrëveshjen për Bartjen e Pronësisë së projekteve të cilan kanë qenë në implementim nga CDI në bashkëfinancim nga ME në vlerë prej 2,655,419€. Sa i pëket regjistrimit të kundërt këto grante kanë kundërlligari Pasuritë në Ndërtim e sipër (Investime në vijim), gjë që kishte ndikuar që kjo kategori të ketë ngritje të theksuar, dhe do të mbahen te kjo kategori deri në momentin e kompletimit final të projekteve dhe kryerjes së pranimit teknik nga komisionet përkatëse këto asete do të kategorizohen dhe do të barten në klasat përkatëse.

### 14. TË HYRAT NGA SHITJET

	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022 RISHIKUAR
Shitjet e ujit	11,773,743	11,494,056
Shitjet/ faturimet për kanalizim	1,771,593	1,760,455
Shitjet e ujit/ tarifaf fikse	2,245,963	2,114,031
Shitjet e ujit/ faturimet tjera	120,562	79,084
<b>Gjithsej</b>	<b>15,911,861</b>	<b>15,447,625</b>

### 15. KOSTO E MALLIT TË SHITUR

Kostoja e mallrave të shitura përfshin koston e drejtpërdrejtë të ujittë blerë të blera, si dhe koston shpenzimet e kemiklajve për trajtimin e ujit. Kosto e mallrave të shitura në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse është analizuar si vijon:

	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022 RISHIKUAR
Kosto e mallit të shitur	754,052	887,418
Kosto e mallit të shitur_kemikale dhe reagentë	474,159	174,954
<b>Gjithsej</b>	<b>1,228,211</b>	<b>1,062,372</b>



## SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

### 16. SHPENZIMET E PERSONELIT

Shpenzimet e personelit janë si vijojnë:

	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022 RISHIKUAR
Shpenzime të pagave	(5,913,382)	(5,350,983)
Shpenzime të pagave- Kontributet	(297,163)	(270,493)
Shpenzime të pagave- Sigurime Shëndetësore	(30,015)	(59,270)
<b>Gjithsej</b>	<b>(6,240,561)</b>	<b>(5,680,746)</b>

### 17. SHPENZIMET OPERATIVE

Shpenzimet tjera operative që gjenden në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse janë analizuar si më poshtë:

	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022 RISHIKUAR
Shpenzimet e rrymës	(2,544,742)	(2,259,814)
Shpenzimet e naftës	(153,418)	(161,449)
Shpenzime tjera të operative	(170,035)	(129,427)
Shpenzime për rekreacion dhe sponsorizime	(1,450)	(3,271)
Shpenzime për shërbime të kontraktuara	(725,774)	(489,963)
Shpenzime për provizionim të kontesteve	(56,054)	(221,010)
Shpenzime të konsumueshme	(266,431)	(238,208)
Shpenzime tjera të përgjithshme administrative	(323,358)	(526,709)
<b>Gjithsej</b>	<b>(4,241,262)</b>	<b>(4,029,850)</b>

### 18. TE ARDHURAT E TJERA

Te ardhurat e tjera që gjenden në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse janë analizuar si më poshtë:

	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022 RISHIKUAR
Të hyra tjera operative	249,109	620,044
Të hyrat nga grantet	981,815	1,175,478
Të hyrat nga provizionet	129,554	-
<b>Gjithsej</b>	<b>1,360,477</b>	<b>1,795,522</b>

## SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

Të hyrat nga provizionet janë të lidhura me Llogaritë e Arkëtueshme nga Shërbimet Bazë, kjo kishte ardhur si rezultat i normës së inkasimit gjë që kishte rezultuar edhe me rënie të saldosh të provizioneve nga kjo kategori.

### 19. SHPENZIMET FINANCIARE

Shpenzimet e interesit dhe tarifat e tjera bankare janë si më poshtë:

	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022 RISHIKUAR
Shpenzime të interesit	136,026	203,955
<b>Gjithsej</b>	<b>136,026</b>	<b>203,955</b>

### 20. TATIMI NË FITIM

Shpenzimet e tatimit në fitim që gjenden në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse janë analizuar si më poshtë:

	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022 RISHIKUAR
Shpenzimi aktual i tatimit në fitim	235,176	326,587

### 21. SHPENZIMET E PROVIZIONIMIT

	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022 RISHIKUAR
Shpenzime të provizionimit	(85,538)	(1,236,264)
<b>Gjithsej</b>	<b>(85,538)</b>	<b>(1,236,264)</b>

Provizionimi ishte kalkuluar konform s rregullores për provizionimin e llogarive të arkëtueshme, në të cilën janë specifikuar normat e provizionimit duke u bazuar në kategorizimin e konsumatorëve varësisht prej ditëve të vonesave, që nga fatura më e vjetër e pa paguar. Gjatë këtij viti kishte pasur ngritje të normës së inkasimit nga shërbimet bazë dhe kishte rezultuar me të hyra nga kjo kategori e provizioneve dhe është pasqyruar tek Shenimi 18. Kurse sa i përket Të Arkëtueshmeve nga Shërbimet dytësore këtë vit kemi njohur shpenzime në vlerë 85,538€. Në tabelën e mëposhtme janë të pasqyruara shkallëzuarat provizionet nga shërbimet bazë.



## SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

Kategoria	Numri i diteve		% e Provizionimit	Vlera e provizionit 2023	Vlera e provizionit 2022
	Prej	Deri			
A	1	30	2%	(3,892)	(15)
B	31	60	5%	-	-
C	60	90	10%	7,010	(7,298)
D	90	180	25%	(9,841)	(16,807)
E	180	365	30%	(9,439)	(10,062)
F	365	730	45%	47,947	(5,338)
G	730	1095	75%	255,831	(9,792)
H	1095		100%	(158,061)	(1,186,953)
<b>Gjithsej</b>				<b>129,554</b>	<b>(1,236,264)</b>

### 22. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA

Në përcaktimin e palëve të lidhura Ndërmarrja zbaton kërkesat e SNK 24. Palët e lidhura përfshijnë:

1. Palët të cilat direkt ose indirekt përmes një ose më shumë ndërmjetësve, kontrollojnë ose janë të kontrolluara nga, ose janë nën kontroll të përbashkët me njësinë ekonomike,
2. Palët për të cilat Ndërmarrja ka një interes që i jep ndikim të rëndësishëm ose kontroll të përbashkët mbi njësinë ekonomike,
3. Individëve privatë të cilët direkt apo indirekt kanë fuqi të votimit në Ndërmarrje, gjë që u jep atyre influencë të rëndësishme mbi Ndërmarrjen, si dhe njësitë ekonomike të kontrolluara ose së bashku kontrollohen nga individë të tillë, anëtarët e personelit drejtues

### 22. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA (VAZHDIM)

4. kryesor, gjegjësisht individët me autoritet dhe përgjegjësi për planifikimin, menaxhimin dhe kontrollin e operacioneve të Ndërmarrjesë duke përfshirë drejtorët,
5. Gjatë marrjes parasysh të transaksioneve me një palë të lidhur vëmendja duhet përqendruar në thelbin e marrëdhënies e jo vetëm në formën ligjore. Ndërmarrja kryen një numër të transaksioneve me palët e lidhura në rrjedhën e operacioneve të saj të rregullta. Transaksionet janë të lidhura me huamarrjet, shpenzimet e transportit, shërbimet doganore, shërbimet e trajnimit etj. Këto transaksione janë kryer në kushte tregtare të rëna dakord reciprokisht.

### 23. VLERA E DREJTË DHE MENAXHIMI I RISKUT

#### a. Menaxhimi i riskut të kapitalit

Ndërmarrja menaxhon kapitalin e saj për të siguruar që do të jetë në gjendje të vazhdojë në vijimësi duke maksimizuar kthimin për aksionarët përmes optimizimit të bilancit të borxhit dhe ekuitetit.

Struktura e kapitalit të Ndërmarrjesë përbëhet nga kapitali që i takon poseduesit të ekuitetit, i përbërë nga kapitali i lëshuar dhe fitimeve të mbajtura.

#### b. Politika të rëndësishme kontabël

## SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

Detajet e politikave dhe metodave të rëndësishme të kontabilitetit të miratuara, duke përfshirë kriteret për njohjen, bazën e matjes dhe bazën mbi të cilën njihen të ardhurat dhe shpenzimet, në lidhje me secilën klasë të pasurisë financiare, detyrimit financiar dhe instrumentit të kapitalit njihen në shënimin 2 në pasqyrat financiare.

### c. Kategoritë e instrumenteve financiare

Deri në fund të vitit Ndërmarrja ka pasur instrumentet financiare si vijon.

	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022 RISHIKUAR
<u>Pasuritë Financiare në koston e Amortizuar:</u>		
Paraja në bankë	4,653,333	2,833,997
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera	4,356,019	5,129,068
<u>Detyrimet Financiare në koston e Amortizuar:</u>		
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera	1,189,666	860,766
Kredia	6,690,723	9,193,675

### d. Objektivat e menaxhimit të riskut financiar

Aktivitetet e Ndërmarrjes e ekspozojnë atë në një shumëllojshmëri të risqeve financiare, duke përfshirë riskun kreditor dhe risqet që lidhen me efektet e ndryshimeve në kurset e këmbimit dhe normat e interesit.

## 24. VLERA E DREJTË DHE MENAXHIMI I RISKUT (VAZHDIM)

### d. Objektivat e menaxhimit të riskut financiar (vazhdim)

Menagjimi i riskut të Ndërmarrjes përqëndrohet në paparashikueshmërinë e tregjeve dhe kërkon të minimizojë efektet e mundshme negative mbi punën e biznesit të Ndërmarrjesë.

Menaxhimi i riskut kryhet nga Bordi i Drejtorëve i bazuar në politikat e para-aprovuara, dhe procedurave të shkruara që mbulojnë menaxhimin e përgjithshëm të riskut, si dhe fusha të veçanta, të tilla si risku i kursit të këmbimit, risku i normës së interesit, risku kreditor, përdorimi dhe investimi i letrave me vlerë të përshtatshme me likuiditetit të tepër.

### e. Risku i tregut

*Risku nga valuta e huaj*

Ndërmarrja operon në arenën kombëtare, në territorin e Republikës së Kosovës, dhe nuk është e ekspozuar ndjeshëm ndaj riskut të këmbimit valuator pasi të gjitha transaksionet deri më 31 dhjetor 2021 janë në Euro.



## SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

Si tërësi, Ndërmarrja nuk është e ekspozuar ndaj riskut të valutës, sepse të ardhurat fitohen në Euro, po ashtu blerjet për pasuritë dhe shërbimet kryesore të cilat përdoren në rrjedhën operative të Ndërmarrjesë janë të shprehura në Euro, si dhe pasuritë financiare janë në Euro.

### Risku i normës së interesit

Risku i normës së interesit përbëhet nga risku që vlera e një instrumenti financiar do të ndryshojë për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut dhe riskun që maturitetet e pasurive që bartin interes ndryshojnë nga maturitetet e detyrimeve që bartin interes të përdorura për të financuar ato pasuri. Gjatësia e kohës për të cilën norma e interesit është fikse në një instrument financiar, tregon se deri në ç'masë është e ekspozuar ndaj riskut të normave të interesit. Ndërmarrja nuk është shumë e ekspozuar ndaj riskut të normës së interesit sepse kreditë e Ndërmarrjesë janë me palë të lidhura me norma fikse.

### f. Risku kreditor

Ndërmarrja është subjekt i riskut kreditor nëpërmjet aktiviteteve të saj të shitjes. Në këtë aspekt, risku kreditor për Ndërmarrjenë buron nga mundësia që palët e ndryshme mund të vonohen për detyrimet e tyre kontraktuale.

Ekspozimi maksimal i Ndërmarrjesë ndaj riskut kreditor përfaqësohet nga vlera kontabël neto e çdo pasurie financiare në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, siç shihet në tabelën e mëposhtme:

	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022 RISHIKUAR
<i>Klasat e pasurive financiare- vlerat kontabël:</i>		
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera	4,356,019	5,129,068
Ekivalentët e parasë në banka	4,653,333	2,833,997
<b>Gjithsej</b>	<b>9,009,352</b>	<b>7,963,066</b>
Garancioni kreditor për kompanitë e lidhura	-	-
<b>Ekspozimi maksimal total ndaj riskut kreditor</b>	<b>6,690,723</b>	<b>9,193,675</b>

## 23. VLERA E DREJTË DHE MENAXHIMI I RISKUT (VAZHDIM)

### g. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare

Menaxhmenti i Ndërmarrjesë konsideron se vlera kontabël e pasurive financiare dhe detyrimeve financiare të regjistruara me kosto të amortizuara në pasqyrat financiare përfaqësojnë vlerat e tyre të drejta për shkak të natyrës së tyre afatshkurtër. Paratë e gatshme në banka përbëhen kryesisht nga llogaritë rrjedhëse, ndërsa detyrimet financiare janë detyrime tregtare me kushte normale të kredisë.

### h. Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit lindë në financimin e përgjithshëm të aktiviteteve të Ndërmarrjesë dhe në menaxhimin e pozicioneve. Ai përfshinë edhe riskun e të mos qenit në gjendje për të financuar pasuritë në maturim të tyre, normave dhe riskun e të mos qenit në gjendje për të likuiduar një pasuri me një çmim të arsyeshëm dhe në një kornizë kohore të përshtatshme për të përmbushur detyrimet.

## SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

### 24. KONTIGJENTET DHE ZOTIMET

Kompania përveq kontesteve të cilat I ka trajtuar tek kategoria e Provizioneve për rastet e kontesteve, ndërmarrja për nga aspekti I detyrimeve kontigjente është e ekspozuar edhe ndaj një padie tjetër e cila përmban vlerë të padisë dhe shuma e supozuar është 3,500€.

Përveq detyrimit kontingjent te cekur me lartë, ndërmarrja është në proces gjyqësor lidhur me gjobën e shqiptuar në fund të vitit 2021 lidhur me inspektimin për periudhen 2014-2017. Kompania ka paguar obligimin e dalë nga gjoba, por duke pasi që nuk është pajtuar me ndëshkimin e marrë ka inicuar procedure ligjore. Shuma e kontestit është mbi 1.7 mln€, mirëpo gjatë vitit 2022 dhe 2023 nuk është mbajtur ndonjë séance gjyqësore, çka do të na mundësonte ta trajtonim më ne detaje këtë kontest duke parapar hyrjen e mjeteve momentare në të ardhmen në kompani.

### 25. NGJARJE PAS DATËS SË BILANCIT

Konflikti Ukrainë-Rusi ka efektet e veta në ekonomi, veçanërisht në rritjen e çmimeve për produktet bazë dhe rënien e fuqisë blerëse për produktet dytësore.

Ndërmarrja ka marrë në konsideratë implikimet dhe ka vënë në zbatim plane të vazhdimësisë së biznesit dhe emergjencave që duhet t'i lejojnë Ndërmarrjes të vazhdojë në mënyrë të arsyeshme operimin në masën e mundshme. Pas rishikimit të parashikimeve të rrjedhave monetare, menaxhmenti e konsideron të përshtatshëm adoptimin e bazës së vazhdimësisë në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare.

Situata e luftës Ukrainë-Rusi vazhdon të përparojë dhe të evoluojë me shpejtësi. Prandaj, shtrirja dhe kohëzgjatja e ndikimit të këtyre kushteve mbeten të pasigurta dhe varen nga zhvillimet e ardhshme që nuk mund të parashikohen me saktësi në këtë fazë, dhe një vlerësim i besueshëm i një ndikimi të tillë nuk mund të bëhet në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare.

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së raportimit që mund të kërkojnë rregullim ose PWRshpalosje në pasqyrat financiare.